

06 Procesi pa lustër i riparimit të pallateve të dëmtuara nga tërmeti

Bashkia e Durrësit shpenzoi mbi 12 milionë euro për rikonstrukcionin e plagëve të tërmetit mbi ambientet e përbashkëta të qindra pallateve, por banorët dhe ekspertët ankohen se ndërhyrjet nuk po i shërbejnë rritjes së sigurisë, por shkëlqimit të fasadave.

12 E anashkaluar, e pandëshkuar: Dhuna ekonomike në Ballkan

Dhuna ekonomike ndaj grave në Ballkan është e përhapur, por shpesh kalon pa u vënë re dhe pothuajse gjithmonë e pandëshkuar. Pasojat janë të thella.

14 'Nëse ata nuk mbjellin, ne nuk bluajmë': Sfidat e prodhimit të drithërave

Biznesi i një fabrike mielli në Has – i njohur dikur si hambari i verilindjes së Shqipërisë – vihet në rrezik nga emigracioni i lartë, mungesa e subvencioneve dhe rritja e kostove të punës në bujqësi.

Reporter.al

Nr. 80

Prill 2022

E përmuajshme

BIRN
BALKAN
INVESTIGATIVE
REPORTING
NETWORK | ALBANIA

FUNDI I PALAVDISHËM I GJIGANDIT TË HIDROKARBUREVE

Tre muaj përpara se çmimi i naftës të arrinte nivelet më të larta historike në treg, Kombinati i Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh u shit për skrap, duke lënë pas një mal me borxhe dhe të ardhura të mungura për autoritetet vendore dhe naftëtarët.



Biznesmeni Shpëtim Shihaku tha se në vend të rafinerisë në Ballsh do të ndërtohet një park fotovoltaiik. Foto: Nensi Bogdani | BIRN.

'NJË MINË ME SAHAT': FUNDI I PALAVDISHËM I GJIGANDIT SHQIPTAR TË HIDROKARBUREVE

04

ADHURIMI NDAJ EDI RAMËS NGRE SHQETËSIME PËR KRIJIMIN E "KULTIT TË INDIVIDIT"

10

E ANASHKALUAR, E PANDËSHKUAR: DHUNA EKONOMIKE NË BALLKAN

12

'NËSE ATA NUK MBJELLIN, NE NUK BLUAJMË': SFIDAT E PRODHIMIT TË DRITHËRAVE NË SHQIPËRI

14

RRITJA E ÇMIMIT TË NAFTËS PO FALIMENTON PESHKATARËT

15

XHENI KARAJ: "NE NUK DUHET TË JEMI QYTETARË TË DORËS SË DYTË"

16



4-5

Tre muaj përpara se çmimi i naftës të arrinte nivelet më të larta historike në treg. Kombinati i Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh u shit për skrap, duke lënë pas një mal me borxhe dhe të ardhura të mungura për autoritetet vendore dhe naftëtarët.



12-13

Dhuna ekonomike ndaj grave në Ballkan është e përhapur, por shpesh kalon pa u vënë re dhe pothuajse gjithmonë e pandëshkuar. Pasojat janë të thella.

ENGLISH EDITION

SOLD FOR SCRAP: ALBANIAN TOWN RUES DEMISE OF AN OIL GIANT

18

LAVISH PRAISES FOR RAMA RAISES CONCERNS ABOUT "CULT OF PERSONALITY"

20

POWERFUL ALBANIAN BUSINESSMEN PICK UP STRUGGLING TV CHANNELS

21

ALBANIA'S PIONEERING LGBT ACTIVIST: 'WE SHOULD NOT BE SECOND-CLASS CITIZENS'

22

UNSEEN, UNPUNISHED: THE ENDURANCE OF ECONOMIC VIOLENCE IN THE BALKANS

26

THE 'AWAKENING': AMERICAN RIGHT-WING EXTREMIST FINDS ALLIES IN THE BALKANS

28



14-15

Biznesi i një fabrike mielli në Has - i njohur dikur si hambari i verilindjes së Shqipërisë - vihet në rrezik nga emigracioni i lartë, mungesa e subvencioneve dhe rritja e kostove të punës në bujqësi.



16

Xheni Karaj, një nga aktivistet e para LGBT në Shqipëri dhe fituese e një çmimi së fundmi nga Civil Rights Defenders, tregon për BIRN për luftën e vështirë me të cilën përballet ende komuniteti i saj në betejën për barazi.

Reporter.al

Është publikimi i Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Investigative në Shqipëri - BIRN Albania. BIRN Albania është një organizatë jo-fitimprurëse, e cila mbështet zhvillimin e gazetarisë investigative në Shqipëri me qëllim ekspozimin e rasteve të korrupsionit dhe promovimin e të drejtave të njeriut në vend. Ky publikim i përmuajshëm është një përmbledhje e disa prej artikujve të botuar nga rrjeti BIRN në faqen www.reporter.al dhe www.balkaninsight.com. Ky publikim shpërndahet falas. Printimi dhe shpërndarja e tij mundësohet nga:

Qeveria Suedeze

National Endowment for Democracy

STAFI

Kristina Voko, drejtoresh e BIRN Albania
Besar Likmeta, Kryeredaktor
Aleksandra Bogdani, redaktore
Gjergj Erebara, redaktor
Vladimir Karaj, redaktor
Edmond Hoxhaj, gazetar

KONTAKTONI:

Rruga Nikolla Jorga,
Kulla 8, Ap. 8, Tiranë
E-mail: office.albania@birn.eu.com
Tel: +35544502592
URL: <http://www.reporter.al/>

Ngjarjet e Prillit



MINATORËT E KROMIT

Minatorët dhe gratë e stogjeve të kromit në Bulqizë punojnë vite të tëra në kushte tejet të rënda e të vështira, disa duke kaluar gjysmën e jetës nëntokë e të tjerë të kërrusur në kërkim të mineralit që është kthyer në burim vdekjeje.

NË FOTO: Fatbardha Karaj dhe dy vajzat e saj mbajnë në duar fotografinë e kryefamiljarit të ndjerë, Fiqiri Karaj.

Nensi Bogdani/ BIRN

PS injoron sanksionet për Aqif Rakipin

Grupi parlamentar socialist injoroi sanksionet e fundit të Shteteve të Bashkuara ndaj ish-deputetit Aqif Rakipi, ndonëse kishte paralajmëruar se do të mbante një qëndrim. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, dy deputetë socialistë e fituan mandatin me mbështetjen e drejtpërdrejtë të njeriut që SHBA-të e cilësojnë “ish-deputeti famëkeq” me lidhje me krimin e organizuar. Djali i tij, Orinaldo Rakipi arriti të thyente herësin dhe u rendit në listën fituese ndonëse nuk kishte asnjë përvojë të mëparshme politike apo publike. Gjithashtu, dhëndri i vëllait të Rakipit, Sajmir Hasalla fitoi një mandat në Elbasan. Kryetari i grupit, Taulant Balla, u mjaftua me një njoftim për mediat që përmbledhonte fjalën e tij para deputetëve në mbledhjen me dyer të mbyllura. Në këtë mbledhje merrte pjesë edhe kryeministri Edi Rama, i cili gjithashtu ka zgjedhur heshtjen për sanksionet amerikane ndaj njërit prej aleatëve të tij në zgjedhjet parlamentare. Përfaqësues të opozitës e konsideruan këtë heshtje të Ramës si mburojë për “non-gratat”.

159 milionë euro dëmi ekonomik

Në një seancë dëgjimore në Komisionin për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit prezantoi raportin e Performancës për vitin 2021. “Aktiviteti qeverisës vazhdon të shfaqë probleme në keq-administrimin e buxhetit,” deklaroi kreu i KLSH, Arben Shehu. “Institucionet me risk më të lartë për dëmin ekonomik rezultojnë të jenë sistemet e doganave dhe të tatimeve,” shtoi ai. Sipas raportit për vitin 2021, dëmi ekonomik total i llogaritur arrin shifrën e 19 miliardë lekë (159 milionë euro), ndërsa efektet negative për shkak të parregullsisve kapin shifrën e 55 miliardë lekë (455 milionë euro). Raporti i Performancës për vitin 2021 u mbështet në 158 auditime të evaduar në 205 subjekte, me synim dhënie e opinionit për zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin e parasë publike, promovimin e llogaridhënies dhe luftën

kundër korrupsionit. Kreu i KLSH-së, Arben Shehu theksoi gjithashtu se janë vërejtur anomali dhe shkelje në projektet konçesionare dhe se qeveria nuk ka kryer monitorim të rregullt të këtyre kontratave.

TV tërheqin investitorë të mëdhenj

Dy biznesmenët më të përfolur në vend për lidhje klienteliste me qeverinë, Samir Mane dhe Shefqet Kasrati, vendosën së fundmi të hyjnë në tregun e televizioneve duke investuar në dy televizione të vogla dhe me humbje. Grupi Balfin, i cili kontrollohet në masën 100% nga Mane, bleu në mars për 700 mijë euro televizionin SCAN, një televizion i hapur në vitin 2001 nga një grup biznesmenësh të kohës, i cili, sipas bilanceve zyrtare të kompanisë të depozituara në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ka pasur një rezultat kumulativ negativ përgjatë pesë viteve të fundit.

Blerja e SCAN nga Mane nuk ishte lëvizja e vetme në këtë treg, i cili në përgjithësi konsiderohet i mbingopur nga pikëpamja komerciale. Kompania nën pronësinë e Shefqet Kasratit njoftoi se ka blerë 60% të aksioneve të kompanisë pronare të kanalit televiziv Euronews Albania. Ajo ka pasur një hyrje të vrullshme në tregun e reklamave, pasi arriti të kontrollojë në vitin e dytë të operimit, viti 2020, 5.3% të tregut me afro 214 milionë lekë të ardhura. Megjithatë, humbjet e akumuluar të kompanisë për vitet 2019 dhe 2020 ishin 59 milionë lekë, ose gati 60% e kapitalit aksioner të paguar prej 100 milionë lekësh.

‘Pakti me median’ i Ramës

Kryeministri Edi Rama tentoi t’u diktojë gazetarëve se çfarë dhe si duhej të raportonin gjatë një konference për shtyp që u zhvillua të enjten me fokus rezultatet e Këshillimit Kombëtar. Duke supozuar se kishte një pakt mes tij dhe mediave, kryeministri u kërkoi gazetarëve të pranishëm në konferencë që të raportonin për temën e konferencës dhe të linin për një hapësirë tjetër përgjigjet e dhëna jashtë kësaj teme. “Duke shpresuar tek

ai pakti, kompromisi që kemi bërë, që për përgjigjet jashtë teme ju do të shfrytëzoni një hapësirë tjetër dhe nuk do të hiqni temën nga raportimi juaj...”, tha Rama në fund të konferencës. I pyetur nga BIRN për ekzistencën e një “pakti” mes kryeministrit dhe mediave, drejtori i Agjencisë për Median dhe Informim, Endri Fuga, tha se “nuk ka ndonjë dokument të shkruar”. Por Fuga pranoi se gazetarëve iu kërkua që të mbulonin temën për të cilën ishte thirrur konferenca. “Është bërë zakon që dikush del për një temë të caktuar e më pas bëhen pyetje për tema të tjera dhe tema për të cilën është dalë në rradhë të parë ‘harrohet’,” shtoi ai. Pretendimi i kryeministrit për një kompromis me median për trajtimin e temave cilësohet “i papranueshëm” nga kryetari i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, Aleksandër Çipa.

Apel për kushtet e spitalit të burgjeve

Komiteti Europian i Parandalimit të Torturës, CPT, shprehu shqetësimin për kushtet e papërshtatshme në të cilat mbaheshin pacientët e burgosur në institucionet e Spitalit të Burgut në Tiranë dhe në Burgun e Zaharisë në Krujë. “Kushte të tilla si tejkalim i numrit të pacientëve, mjedise të prishura dhe kujdes psikiatrik i pamjaftueshëm,” citohet në raportin e CPT për vitin 2022. Në kohën e vizitës së CPT, Institucioni i Veçantë i Zaharisë në Krujë kishte 314 pacientë të burgosur meshkuj, por jo mjaftueshëm staf të suportit psikoterapeutik. Sipas Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, shteti duhet të sigurojë kushte të tilla që pacientët e burgosur të marrin trajtimin e duhur mjekësor për t’u përmirësuar dhe për t’u ri-integruar në shoqëri, duke mos paraqitur më rrezikshmëri për të tjerët. “Komiteti i Parandalimit të Torturave e sheh alarmant faktin që në një periudhë kohore më të vogël se 5 vjet, prej Shkurtit të 2017 deri në Nëntor 2021, numri i pacientëve psikiatrik meshkuj të cilët janë urdhëruar me vendim gjykatë për trajtim të detyrueshëm sipas Pjesës 46 të Kodit Penal, është rritur nga 153 në 217 veta, gjë që përkthehet në një rritje prej 40%,” thuhet në raport.

INVESTIGIM

‘Një minë me sahat’: Fundi i palavdishëm i gjigandit shqiptar të hidrokarbureve

Tre muaj përpara se çmimi i naftës të arrinte nivelet më të larta historike në treg, Kombinati i Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh u shit për skrap, duke lënë pas një mal me borxhe dhe të ardhura të mungura për autoritetet vendore dhe naftëtarët.

OLAXAMA | BIRN | BALLSH DHE TIRANË

Në hyrje të bashkisë së Mallakastërës ndodhet një pikë e vogël karburanti me logon e kompanisë së madhe të karburanteve ‘Kastrati’. Çmimi i një litri naftë në mesin e muajit mars në këtë pikë shërbimi kishte arritur 191 lekë për litër.

Sipas banorëve vendas, kjo është hera e parë në zonë që çmimi i naftës arrin rekorde të tilla, pasi historikisht një litër naftë kush-tonte 50 lekë më lirë se në qytetet e tjera të vendit - i ndikur pozitivisht nga prodhimi i rafinerisë së Ballshit.

“Çmimi i lartë i naftës në Ballsh nuk ka qenë asnjëherë kaq shtrenjtë se ishte vend që e prodhonte dhe e përpunonte vetë,” kujton Sokol Dautaj, kryetar i Sindikatës së Naftëtarëve të Ballshit.

Prej muajsh në Ballsh, zhurma që dikur krijonte Kombinati i Përpunimit të Thellë të Naftës nuk dëgjohet më. Ajo është zëvendësuar me kërcitjet e makinerive të rënda, që po e çmontojnë kombinatin, ndërsa herë pas here kamionë të ngarkuar me hekur kalojnë në rrugën që lidh rafinerinë me qendrën e Mallakastërës.

Dokumentet dhe dëshmitë e siguruar nga BIRN tregojnë se mbyllja e kombinatit dhe çmontimi i tij për skrap është bërë me bekimin qeverisë së kryeministrit Edi Rama, e cila ka miratuar ndërtimin në vend të tij të një parku fotovoltaik. Ky vendim erdhi pas vitësh keqmenaxhimi dhe borxheve të krijuara nga kompania ARMO, që solli ekzekutimin e kombinatit në Ballsh si kolateral nga Banka Credins. Pas disa përpjekesh të dështuara për ta rivënë në punë rafinerinë, Banka Credins ia shiti rafinerinë kompanisë “Shijaku” për 9 milionë euro, me qëllim çmontimin dhe shkrirjen e saj për hekur skrap.

BIRN mësoi gjithashtu se kompania “Shijaku” nuk është pajisur me leje për prishjen e uzinës nga Bashkia Mallakastër, e cila insiston se nuk ka kompetenca mbi një sektor strategjik si hidrokarburet.

Kompania “Shijaku” i tha BIRN se për momentin është duke bërë vetëm çmontimin e pjesëve të luajtshme të uzinës, pasi po pret që të marrë përgjigje nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit - si për lejen e prishjes, ashtu edhe për ndërtimin e parkut fotovoltaik.



Kryetari i sindikatës së naftëtarëve të Ballshit, Sokol Dautaj. Foto: Nensi Bogdani/ BIRN.

Ndërkohë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë mohon të ketë një rol në prishjen e uzinës, duke e konsideruar tërësisht si një transaksion privat mes bankës Credins dhe kompanisë Shijaku.

“Uzina ishte një gangrenë së fundi, një problem, një minë me sahat dhe nëse do të vazhdonte të rrinte e paadministruar, do të krijonte shumë më tepër probleme ekologjike, mjedisore dhe komunitare,” tha zëvendësministri i Energjisë dhe Infrastrukturës, Ilir Bejtja. Ai shtoi se prishja e saj jep mundësinë e ndërtimit të një impiantit të ri, i cili ‘do të punësojë njerëz, si gjatë ndërtimit dhe gjatë funksionimit.’

Edhe administratori i kompanisë “Shijaku” insistoi se dërgimi për skrap i uzinës përbente një risi për tregun shqiptar, kur

shumë fabrika të vjetra të ndërturara gjatë kohës së ish-regjimit komunist ndosin ende qendrat e qyteteve industriale.

“Fati i naftëtarëve apo zonës së Mallakastërës është mjaft i mirë, që kjo gangrenë të mos i kapë dhe brezat që vijnë,” tha Shpëtim Shijaku, ndërsa premtoi se uzina do të kthehet në një zonë ekologjike.

Rrënimi i ARMO-s

Kombinati i Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh filloi punë në vitin 1975. Së bashku me rafinerinë e Fierit që u hap në vitin 1968, ai ishte në pronësi të kompanisë publike të hidrokarbureve Albpetrol. Në vitin 1999, Albpetrol u nda në tre shoqëri tregtare, SERCOM për shpërndarejn e naftës, ARMO për rafinimin e saj dhe Albpetrol për prodhimin e naftës bruto. Dy rafineritë bashkë me tre degë të shitjes me shumicë, një institut kërkimor, një terminal eksporti, si dhe kapacitete depozitimi prej 220 mijë metër kub naftë, iu transferuan si asetë kompanisë Albania Refining and Marketing of Oil, ARMO. Në vitin 2008, 85% e aksioneve të ARMO-s u privatizuan nëpërmjet kompanisë Anika Mercuria Refinery Associated Oil, AMRA Oil, për 128 milionë euro. AMRA Oil ishte 80% në pronësi të Anika Enterprises – një kompani e regjistruar nga biznesmeni Rezart Taçi në Zvicër – dhe 20% në pronësi të Refinery Associates of Texas. Nga viti 2009 deri në 2013, nën drejtimin e biznes-



Biznesmeni Shpëtim Shijaku tha se në vend të rafinerisë në Ballsh do të ndërtohet një park fotovoltaik. Foto: Nensi Bogdani/BIRN.



menit famëkeq dhe me lidhje të ngushta me familjen e ish-kryeministrit Sali Berisha, ARMO u rrënua nga një kompani e shëndoshë financiarisht në një shoqëri aksionere të mbytur në borxhe ndaj bankave, Tatimeve dhe furnitorëve.

Në gusht 2013, paketa kontrolluese e aksioneve të Taçit tek ARMO iu shit kompanisë ‘offshore’ me pronësi azere, Heaney Assets Corporation, e cila pagoi 50 milionë euro.

Azerët tentuan ta rivinin në punën ARMO-n, duke i dhënë me qira rafineritë e saj në Fier dhe Ballsh, por barra e detyrimeve të kompanisë ishte e papërballueshme dhe e çoi atë drejt kolapsit. Sipas zëvendësministrit të Energjisë dhe Infrastrukturës, Ilir Bejtja, deri në vitin 2014 kompania ARMO kishte akumuluar gati 500 milionë USD borxhe dhe detyrime të pashlyera.

“I gjithë kapitali i nënshkruar i kompanisë ishte rreth 495 milionë USD, ndërkohë që borxhi i vet në fund të 2014-s shkonte diku te 493-494 milionë USD,” shpjegoi Bejtja.

Një prej kreditorëve të shumtë të ARMO-s ishte dhe Banka Credins, e cila në nëntor 2016 arriti ta ekzekutonte kolateralin për një borxh të pashlyer prej 20 milionë eurosh, duke marrë në pronësi rafinerinë e Ballshit.

Banka Credins fillimisht ia shiti rafinerinë kompanisë IRTC Sha - në pronësi të biznesmenit Besnik Sulaj. Por pasi IRTC nuk arriti të paguante kredinë me të cilën ishte financuar ky operacion, rafineria e Ballshit iu kthye sërish bankës. Banka Credins përdori të njëjtin skemë në shtator të vitit 2017, duke e shitur për herë të dytë rafinerinë tek kompania Allum Enterprises për 2.8 miliardë lekë (22 milion euro). Në shkurt 2018, kjo kompani materializoi një marrëveshje me shoqëritë Bylis dhe Tosk Energji dhe ato punuan në Ballsh deri në 17 shtator 2019.

Megjithëse puna u ndërpre, kompanitë Bylis dhe Tosk Energji e mbajtën rafinerinë deri në shkurt 2020, kohë kur u çliruan nga marrëveshja me Allum Enterprises. Ngjashëm me IRTC, edhe Allum Enterprises nuk arriti ta paguajë kredinë ndaj Bankës Credins, të cilës



Makineritë e rënda të kompanisë "Shijaku" po çmontojnë hekurin e rafinerisë. Kompania premtom të ndërtojë një park fotovoltaik në vend të rafinerisë. Foto: Nensi Bogdani/ BIRN



Naftëtarët e Ballshit ankohen se janë lënë në terr infirmativ për fatin e rafinerisë. Foto: Nensi Bogdani/BIRN.

iu kthye përsëri aseti i kolateralizuar.

Pasi e rimori rafinerinë nga Allum Enterprises, banka ia shiti atë në fillim të vitit 2022 kompanisë "Shijaku", për ta çmontuar dhe shitur për skrap. Dokumentat e siguruar nga BIRN tregojnë se rafineria e Ballshit u shit nga Banka Credins për kompaninë "Shijaku" sh.p.k kundrejt një shume prej 9 milionë eurosh, përmes një linje kredie që vetë banka i dha kompanisë.

"Dhashë ofertë pranë bankës, pasi ajo e kishte nxjerrë në shitje dhe bleva rafinerinë për 9 milionë euro," tha Shpëtim Shijaku për BIRN. "Këtë shumë të plotë e kam marrë kredi pranë kësaj banke," shtoi ai.

Banka Credins i tha BIRN se për disa vite u përpoq që ta vinte në shfrytëzim kombinatin e Ballshit, por pas disa përpjekjeve të dështuara dhe vlerësimeve të bëra nga investitorë potencialë se ajo nuk ishte e shfrytëzueshme dhe rentabël, hoqi dorë duke pranuar ofertën për shitjen e saj për skrap.

"Kompania Shijaku Shpk ka blerë asetin e marrë në pronësi të Bankës pas disa transaksioneve shit-blerjesh... të cilat kanë rezultuar të dështuara, duke qenë se klientët e kanë patur të pamundur të sjellin në efikasitet operativitetin e rafinerisë," tha Banka Credins në një përgjigje me shkrim.

"Banka mbështet me kredi klientët, të cilët

rezultojnë fizibël në plotësimin e kushteve bankare për ktheshmërinë e financimeve të marra, bazuar në planet e biznesit dhe kolateralat që këta klientë vënë në dispozicion të saj," shtoi Credins.

Shpëtim Shijaku i tha BIRN se në fund të vitit 2023, në vend të Kombinatit të Përpunimit të Naftës në Ballsh do të ngrihet një park me panele diellore, me një fuqi prodhimi energjie prej 100 MËh, i shtrirë në të gjithë sipërfaqen prej 73 hektarë të uzinës.

"Ju premtoj që do të bëj një investim serioz, arrin në afërsisht 60 milionë euro, dhe do të jetë gati brenda vitit të ardhshëm," tha ai, ndërsa shpjegoi se "prona është e pastër, nuk ka askush pretendime."

Për të kryer investimin, Shijaku sqaron se do t'i drejtohet sërish bankave tregtare për të marrë kredi për financimin e projektit.

"Energjia do të shitet në treg të lirë, në bursën shqiptare "Alpex", nuk do të jetë pjesë e tregut të rregulluar," theksoi ai.

"Leverdia më e madhe është që linja elektrike dhe nënstacioni janë aty dhe nuk ka nevojë për investime të mëdha," shpjegoi Shijaku, ndërsa shtoi se "janë linja që i mbajnë kapacitete të larta energjie sepse dikur furnizohej rafineria."

Edhe pse bashkia Mallakastër e kufizoi deri diku çmontimin e rafinerisë, pasi nuk i

ka dhënë ende lejen e prishjes kompanisë "Shijaku", autoritetet e tjera të lidhura me pushtetin qendror i kanë dhënë dritën jeshile ndërtimit të një parku fotovoltaik në vend të uzinës.

Në dy dokumente të siguruar nga BIRN rezultojnë se Operatori i Sistemit të Transmetimit, OST është shprehur pozitivisht në një opinion paraprak ndaj kërkesës së kompanisë "Grennat Solar Park Ballsh" për përdorimin e linjës së tensionit të lartë 110 KV për ndërtimin e një parku fotovoltaik në Ballsh. Po ashtu, edhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka pranuar aplikimin e saj për leje paraprake, por nuk e ka shqyrtuar ende kërkesën.

'Funerali' i Mallakastërës

Adrian Hoxha punoi për 31 vjet në uzinën e Ballshit në sallën e komandës së hidro-pas-trimit. Ai thotë se ndjehet sot i pafuqishëm dhe i poshtëruar, pasi nuk e kishte menduar ndonjëherë se fundi i ndërmarrjes do të ishte çmontimi dhe shitja e saj për skrap.

"Sot Mallakastër është shkelur me këmbë," tha Hoxha, ndërsa kujtoi se me mbylljen e rafinerisë kanë humbur punën 1 mijë punëtorë. "I bënë varrin Mallakastërës," shtoi ai.

Fjalën 'funeral' e përmend edhe biznesmeni Shpëtim Shijaku që po kryen demelimin e teknologjisë së uzinës. Fitimi që duhet të gjenerojë kompania nga shitja e hekurit të rafinerisë për skrap duhet të kalojë çmimin e blerjes prej 9 milionë euro, por ky vlerësim ka risqet e veta thotë Shijaku.

"Unë jam biznes ndryshe nga të tjerët, merrem me pjesën e fundit të një objekti. E quaj biznes funeral, pasi kam marrë një gjë të vdekur dhe do e ringjall," rrëfen Shijaku.

"Risku në këtë lloj biznesi është i lartë, sepse unë kam blerë hekur dhe nuk e di gjendjen faktike të tij," shtoi ai.

Megjithë pikëpyetjet që ngre biznesmeni për çmontimin e rafinerisë, nga shkrirja e saj për skrap qindra naftëtarë kanë mbetur pa punë dhe shumë prej tyre pa shpresë.

Qeveria ka miratuar një rrogë prej 30 mijë lekësh në muaj për ish-punonjësit e rafinerisë, në mënyrë që të zbusë pasojat sociale të mbylljes së saj. Shumë prej naftëtarëve që janë në moshë të madhe kanë vështirësi të gjejnë punë të tjera në sektorin privat. "Kam vajtur në 20 firma dhe sa më shohin moshën nuk ma hap derën kush," thotë Adrian Hoxha, i cili ka tre fëmijë në shkollë të lartë. "Më duhen dhe 4 vjet që të kap moshën (60 vjeç) që të dal në pension," shpjegoi ai.

Njësoj si Adriani janë dhe dhjetëra naftëtarë të tjerë, që kanë vështirësi të gjejnë punë dhe shumë prej tyre shohin si rrugën e vetme që u ka mbetur atë të emigrimit.

"Jemi shumë të zhgënjyer, jemi 300 veta që na kanë hedhur në rrugë se të tjerët dolën në pension dhe mua më duhen dhe 3 vjet të marr statusin e naftëtarit të dal në pension të parakohshëm," tha një prej ish-punonjësve të rafinerisë, i cili preferoi të mbetej anonim.

Në syrin e qeverisë, trajtimi financiar që u është bërë naftëtarëve është më i miri që mund të ofrohet sot nga ndihma shtetërore.

"Nga ana sociale, ndihma ka qenë më shumë se optimale, ku është rast unik që shteti duke marrë parasysh plagën e madhe sociale që shkaktoi mbyllja e uzinës në qytetin e Ballshit, ka marrë përsipër t'u garantojë atyre për 3 vjet pagën," tha zv.ministri Bejtja. Ai sqaron se përveç pagës së punëtorëve të mbetur pa punë, tashmë qeveria ka zgjidhur dhe problemin e ujësjellësit dhe të nënstacionit elektrik në zonën e Mallakastërës, të cilat ishin në pronësi të ARMO-s dhe furnizimi me ujë dhe drita varej nga humori i

investitorëve.

Bejtja theksoi se ARMO ka akumuluar 40 milionë USD detyrime për energjinë elektrike gjatë viteve. "Ishin në mëshirën e fabrikës, duam ju japim, nuk duam s'ju japim," shpjegoi ai. Kreu i sindikatës së naftëtarëve, Sokol Dautaj thotë se ndihma e qeverisë prej 30 mijë lekësh është tallje në krahasim me kontributin e naftëtarëve në sektorin e hidrokarbureve.

"Ne kemi kërkuar mbrojtje financiare momentale me premtimin që do të riktheheshim në punë," tha ai.

Prej vitesh, Dautaj dhe naftëtarët e tjerë enden nëpër gjykata me padi kundër ARMO-s për 13 paga të papaguara në vitin 2014. Ata nuk kanë mundësi të bllokojnë asnjë ndërtesë të uzinës, pasi të gjitha pronat si në Ballsh dhe në Fier u ekzekutuan si kolateral në favor të bankave. "Rafineria po shkatërrohet ditën dhe natën - po del si mall pa investitor, pajisje me vlerë kolosale po shiten si pjesë skrapit me peshë," ankohet Dautaj.

"Nëse ne fitojmë gjyqin, ku do të vihet sekuestro nesër," pyet kreu i Sindikatës së Naftëtarëve. Dautaj beson se ligjvënësit mund të ofrojnë ende një zgjidhje. Ata i kanë bërë një peticion parlamentit për shpalljen e falimentit të ARMO-s dhe gjetjen e një mënyrë për të kompensuar punonjësit për pagat që nuk i kanë marrë.

"Në momentet që flasim ka një terr informativ. I kemi kërkuar shpjegime të gjitha palëve dhe askush nuk na ka servitur letrat, ndërkohë që po shohim që po ndodh shkatërrimi i rafinerisë," tha ai. "Rafineria po shkatërrohet në mënyrën më barbare, po shkon për skrap një rafineri që ishte e vetme në Ballkan, e cila e ka ndaluar aktivitetin e saj në gjendje pune," përfundoi Dautaj.

Taksat e munguara

Papunësia në Mallakastër është rritur tashmë prej muajsh, ndërsa vetë financat e bashkisë që menaxhon këtë zonë janë të rrënuara për shkak të detyrimeve që lanë në kohë investitorët e rafinerisë, por dhe nga taksat e munguara që tashmë nuk do të shkojnë më të buxhetin e kësaj njësie vendore.

"Janë rreth 800 mijë USD në vit që i mungojnë buxhetit të bashkisë nga mbyllja e rafinerisë dhe për nivelin e buxhetit të bashkisë tonë janë një zë shumë i rëndësishëm," thotë Zamir Malasi, nënkryetar i bashkisë Mallakastër, cili pranon se mbyllja e rafinerisë ka ndikuar negativisht në financat e bashkisë.

Malasi thotë se përveç taksave të munguara, ARMO ka dhe detyrime të papaguara ndaj bashkisë së Mallakastërës.

"Rafineria na ka lënë detyrime, vetëm 3 vitet e fundit janë 2.5 milionë USD, ndërsa në total bashkë me vitet e tjera shkojnë në afro 6 milion USD," shpjegoi ai. Sipas Malasit, investimet në sektorin e hidrokarbureve kërkojnë kapital të madh, ndërsa të vetmet biznese që janë afruar që prej mbylljes së rafinerisë në Mallakastër janë ato të sektorit të fasonerisë. "Situata e naftëtarëve është e vështirë dhe janë problem social për zonën," tha gjithashtu Malasi. "Ata sot po marrin një pjesë pension të parakohshëm e një pjesë ndihmë financiare, sepse problematikën e punësimit e zgjidh vetëm tregu," shtoi ai.

Për nënkryetarin e bashkisë, shkatërrimi i uzinës erdhi si shkak i shfrytëzimit pa kriter dhe mungesës së investimeve.

"Faji për shkatërrimin e rafinerisë është degradimi në vite dhe mungesa e investimeve, sidomos pas momentit të privatizimit, pasi në fokus ka qenë vetëm shfrytëzimi," tha ai.

"Nëse do të kishte pasur investime, uzina do të ishte në punë, bashkia do të kishte të ardhura dhe naftëtarët do të ishin në punë," përfundoi Malasi.

INVESTIGIM

Procesi pa lustër i riparimit të pallateve të dëmtuara nga tërmeti

Bashkia e Durrësit shpenzoi mbi 12 milionë euro për rikonstruksionin e plagëve të tërmetit mbi ambientet e përbashkëta të qindra pallateve, por banorët dhe ekspertët ankohen se ndërhyrjet nuk po i shërbejnë rritjes së sigurisë, por shkëlqimit të fasadave.

GERIEMIRI | BIRN | DURRËS

Paraditen e 16 prillit, Dhimitër Stefa dhe fqinjët e tij u mblodhën të shqetësuar në shkallët e palatit të tyre në afërsi të stadiumit të Durrësit, për të diskutuar mbi cilësinë e punimeve të saponisura nga bashkia.

Pallati 5-katësh me tulla të kuqe është ndërtuar në vitin 1975 me kontribut vullnetar dhe pas tërmetit shkatërrimtar të 26 nëntorit 2019, u klasifikua me nivel dëmi të lehtë DS1.

Suvatimi i fasadës kishte nisur prej një jave, por Stefa, 61 vjeç, është i paqartë dhe i pakënaqur.

“Asnjë nuk të jep informacion se çfarë do të bëhet,” tha Stefa për BIRN.

“Ky është maskarallëk, dy pallate më poshtë me kapotë dhe punimet e brendshme të shkallëve, edhe me bojë. Erdhi puna tani që po bëhet suvatimi i palatit tonë, as kapotë, as shkarkimi i ujërave të shiut, as planifikim për lyerje të brendshme,” shtoi ai.

Riparimi i pallatit të Stefës është pjesë e procesit të rindërtimit në qytetin e Durrësit – më i godituri nga lëkundjet e tërmetit të tre viteve më parë. Procesi ka nisur prej shtatorit 2020, por fundi i tij duket ende larg.

Sipas të dhënave të siguruar përmes një kërkese për të drejtë informimi, qeveria shqiptare dhe bashkia e Durrësit kanë shpenzuar rreth 3 miliardë lekë [25 milionë euro] për riparimin e pallateve me nivel dëmi DS1-DS3 si dhe për rforcimin strukturor të pallateve me nivel dëmi DS4 që prej vitit 2020.

Rreth 1.4 miliardë lekë ose 46% e fondit shkoi për riparimin e ambienteve të përbashkëta të qindra pallateve me sh-

kallë të lehta dhe të mesme dëmi (DS1-DS3) – punime të cilat u ndanë në 11 lote dhe po kryhen nga kompanitë private të përzgjedhura nga bashkia.

Qeveria shqiptare ka premtuar se procesi i rindërtimit do t’u japë zgjidhje mijëra qytetarëve që humbën shtëpitë nga fatkeqësia natyrore si dhe do të kontribuojë në rritjen e sigurisë së qindra godinave në vend.

Megjithatë, të dhënat që BIRN siguroi përmes vëzhgimeve në terren dhe intervistave me banorë dhe ekspertë të ndërtimit tregojnë se investimet po i shërbejnë estetikës së fasadave më shumë sesa sigurisë së pallateve.

“Këto në 90% të rasteve janë lyerje fasdash, rehabilitim fasdash dhe në 10% janë rikonstruksione të mirëfillta,” tha për BIRN një inxhinier ndërtimi, i cili foli në kushtet e anonimatit nga frika e penalizimit të aktivitetit të tij profesional.

“Pra, janë punime të cilat nuk synojnë riparimin e strukturës së godinës, por përmirësimin e estetikës së saj, përmes suvatimit dhe lyerjes,” shtoi ai.

BIRN dokumentoi gjithashtu në terren punime difektoze, standarde të ndryshme si dhe punë “shkel e shko” që u ka dalë tashmë boja.

Ndërkohë, Bashkia e Durrësit tha përmes një përgjigje me shkrim se ndërhyrjet po kryheshin në përputhje me aktet e vlerësimit të dëmeve.

“Procesi i vlerësimit të dëmeve është proces që ka nisur që në vitin 2019 dhe janë hartuar akte konstatimi, ekspertizat e thelluara nga Instituti i Ndërtimit Tiranë,” tha Bashkia e Durrësit.

“Hartimi i projekteve/ specifitimeve teknike është bërë në përputhje me kërkesat e akteve të konstatimit,” shtoi ajo.



Pallati 793 ku banon Dhimitër Stefa po riparohet sipas banorëve me cilësi të dobët. Foto: Geri Emiri

Vonesa dhe defekte

Tërmeti i 26 nëntorit 2019 shkaktoi 51 viktima dhe mijëra të pastrehë të Shqipëri, ndërsa bashkia e Durrësit - qendra e dytë më e madhe e vendit – u kthye për javë të tëra në një qytet fantazmë.

Në shkurt të vitit 2022, kryetarja e bashkisë së Durrësit, Emiriana Sako deklaroi pëmes një statusi në Facebook se kishte përfunduar riparimi i ambienteve të përbashkëta për 405 pallate me nivel dëmi DS1-DS3 dhe ishin në proces 180 pallate të tjera.

Sako shtoi gjithashtu se kishte përfunduar përfundimi dhe rikonstruksioni për 4 pallate me nivel dëmi DS4 dhe se po vijonte puna për 24 pallate të tjera.

BIRN analizoi 11 tendera dhe mori informacion nga Bashkia Durrës, duke evi-

dentuar punimet e parashikuara për pal-latet në ambientet e përbashkëta, që përfshijnë fasadën e objektit dhe kafazin e shkallëve.

Ato përqendrohen në godinat me nivel dëmi DS1, DS2 - që njihen si dëmtime të lehta në strukturën e godinave dhe DS3, që njihet si nivel i mesëm dëmi.

Procesi i tenderimit të tyre u nda në 11 lote me një vlerë totale prej 1.4 miliardë lekësh [12 milionë euro] për pallate që shtrihen nga qendra e qytetit dhe deri te njësitë administrative më të largëta.

Nga 11 lotet, nëntë u prokuruan në shtator 2020 dhe përfshinin 393 pallate, ndërsa dy të tjerat në mars 2022.

Në terren, procesi i riparimeve u përball me shkelje të kontratave dhe amendime të tyre, duke sjellë zvarritje të ndë-



Ilustrim nga Jurgena Tahiri | BIRN



Një pallat i rikonstruktuar pranë stadiumit të Durrësit, ku ka rënë një pjesë e suvasë. Foto: Geri Emiri.

tashmë përtokë apo ku lagështira kishte krijuar harta mbi suvatimet e reja.

Skënder Lika banon në katin e dytë të një pallati të para viteve '90 në lagjen numër 18 të Durrësit, i cili u rikonstruktua në fasadë dhe kafazin e shkallëve para zgjedhjeve parlamentare të 25 prillit.

Megjithatë, një bllok suvatimi me gjatësi mbi 1 metër është shkëputur prej kohësh nga fasada dhe ka rënë përtokë.

“Ata bënë suvatim, fino dhe lyerje. Nuk marr vesht nga ndërtimi, por siç ishte është mirë,” tha Lika për BIRN.

“Pjesa lart që ka rënë nuk do ketë kapur mirë. Ra pasi e riparuan,” shtoi ai.

Sipas inxhinierit të ndërtimit me të cilin foli BIRN, defektet janë pasojë e mungesës së kushteve teknike të zbatimit. Ai vëren gjithashtu si problem kryesor neglizhimin e lagështirës përgjatë punimeve.

“Po nuk u bë hidroziolim për lagështirën, do të shpërndahet kudo. Kur lagështira është prezente, nuk ka vlerë suvatimi dhe lyerja, duhej ndërhyrë fillimisht për heqjen e lagështirës,” shtoi ai.

Arnimi i dëmeve

Pak pasi kalon kryqëzimin e stadiumit në Durrës, pallatet shumëkatëshe bartin ende plagët e tërmetit të nëntorit 2019. Më të dukshme janë tek suvatimet e pallateve të ndërtuar rishtazi, sesa në tullat e disakatësheve të përpara viteve '90.

Ekspertët mendojnë se procesi i rindërtimit është përbullur me probleme si në vlerësimin e dëmeve, ashtu edhe në zbatimin e punimeve. Sipas planifikuesit të territorit, Artan Kacani, mënyra se si u vlerësuan dëmet nuk ishte “një recetë e duhur teknike” që përmbush pritshmëritë e qytetarëve.

“Teknikisht, godina të ndryshme kanë dëmtime nga më të ndryshmet...,” tha Kacani, ndërsa shtoi se për çdo problem do të duhej të kërkoheshin zgjidhje specifike.

“Sot ne kemi godina që paçka se mund të kenë vlerësimin DS1, bartin në vetvete probleme themelore, duke filluar edhe nga apartamentet individuale,” shtoi ai.

Edhe inxhinierët e ndërtimit me të cilët foli BIRN bien dakord se për procesin e rikonstruksionit do të duhej të specifikoheshin problemet konkrete që kishte secila godinë. Ata vërejnë se ndryshe nga kjo praktikë, në dokumentet e tenderave gjendet numri total i godinave dhe një udhëzues tip për ndërhyrjet.

Në terren, procesi i rindërtimit përketet shpeshherë në ndërhyrje kakofonike dhe arnime të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti.

BIRN vëzhgoi disa blloqe banimesh të riparuar në lagje të ndryshme të Durrësit dhe dokumentoi se shumica e ndërhyrjeve

lidhen me suvatimin e fasadës së pallateve; në disa raste me izolim dhe sistem kapotë dhe në raste të tjera me proces të thjeshtë.

Standarde të ndryshme janë ndjekur gjithashtu me ambientet e shkallëve, ku të çarat e krijuara nga tërmeti herë janë riparuar dhe herë të tjera jo.

Në terren mungojnë gjithashtu tabela të punimeve dhe mungesa e specifikimeve teknike ka krijuar konfuzion mes banorëve. Në varësi të cilësisë së punimeve, disa banorë shprehen të kënaqur dhe të tjerë të zhgënjyer.

Në një tjetër pallat 5-katësh pranë stadiumit të Durrësit, Dashuria, një grua në pension është falenderuese për punimet.

“Kanë pasur krisje muret, suvatimet, i kanë gërryer, i kanë suvatuar, i kanë lyer me bojë, me rrjetë, me të gjitha siç i takon. Edhe fasadën jashtë komplet, i kanë bërë izolim me tapë se këto kanë qenë në tullë komplet pallatet këtu,” tha ajo për BIRN.

Ndryshe mendon Julinda Capari, e cila banon prej 32 vitesh në një pallat 4-katësh që mban numrin 1015 në zonën e Shkozezit. Pallatet në këtë bllok banimi janë suvatuar dhe lyer vetëm në njërin anë të fasadës që sheh nga rruga kryesore, ndërsa në pjesën e pasme dallohet ende boja e vjetër dhe të çarat e tërmetit në kafazin e shkallëve.

“Të gjitha këto [dëmtimet e suvatimit] nga tërmeti janë, është edhe një copë e madhe diku më poshtë. Një herë të bie tërmet, bëhen prapë,” tha Capari, duke treguar me gisht të çarat në mure.

Në pallatin fqinj me Caparin, 62-vjeçarja Safete Zylfyfi thotë se zyrtarët e bashkisë u prematuan rikonstruksionin para zgjedhjeve të përgjithshme, por ende nuk është bërë asgjë.

“Kryetarja e bashkisë erdhi e pa atë [pallati përballë] kur i mbaroi suvatimi. Duhej që edhe ne të na e suvatonin, se tha do i bëjmë të gjitha me radhë, edhe nuk u bë ashtu. U bë vetëm njëra, se si ishte plani nuk e di, vetëm atje u suvatua,” shton 62 vjeçarja.

Banorë të tjerë si Dhimitër Stefa ankojnë se mungesa e transparencës dhe e informacionit krijon hapësira për abuzime. 61-vjeçari thotë se riparimet do të duhej të shoqëroheshin me tabela informuese, ku të shënoheshin të gjitha punimet e parashikuara për të shmangur konfuzionin.

“Këto janë investime publike që i bënë bashkia e Durrësit dhe firma duhet të jetë transparente dhe të nxjerrë një tabelë aty, ku të thotë se do të kryhen këto punime,” tha Stefa i zhgënjyer.

“Le të shkruajnë apriori 40 pallate, por edhe punimet që ne ta dimë,” përfundoi ai.



Julinda Capari tregon krisjet e tërmetit në shkallët e pallatit të riparuar. Foto: Geri Emiri.

rhyrjeve me të paktën disa muaj.

Sipas bashkisë së Durrësit, nëntë kontratat e lidhura në vitin 2020 u amenduan për arsye që lidheshin me kushtet atmosferike, me vështirësitë për të liruuar katet e para të zëna nga bizneset apo me kohën e nevojshme për të identifikuar të gjitha godinat objekt të kontratave.

Si arsye të vonesave, bashkia përmend edhe situatën e krijuar me pandeminë e COVID-19 dhe pamundësinë për të gjetur banorët.

Vonesat duket se kanë sjellë një efekt domino dhe i kanë dekurajuar qytetarët që presin tashmë prej kohësh që t'u vijë radha.

Redi Myshketa, banor i lagjes 6 të Durrësit thotë se në pallatin e tij 12-katësh të klasifikuar si DS3 puna nuk ka filluar

ende, ndonëse duhej të kishte mbaruar para një viti.

Pas tërmetit të 26 nëntorit, pallati i Myshketës pësoi dëme në shkallë, në fasadë dhe në muraturë. Banorët i kanë riparuar tashmë dëmet e brendshme, por fasada e pallatit ka mbetur po njësoj.

“Ka komshinj që e kanë prishur murin nga brenda, por nuk e kanë suvatuar dot nga jashtë, sepse nuk e suvaton dot nëse nuk merr skelën,” tha Myshketa për BIRN.

“Ata nuk e japin [lejen për skelën] kështu që do të presim kur të kujtohet shteti të bëjë rikonstruksionin,” shtoi ai.

Vonesat me punimet nuk janë problemi i vetëm. Në dhjetra pallate të riparuar tashmë nga bashkia, BIRN evidentoi raste ku copa të mëdha suvaje kishin rënë

Qeveria shqiptare prezantoi në parlament një vit e gjysmë më parë amnistinë fiskale, ku në relacionin shoqërues shkruhet e zehtë mbi të bardhë se kjo është një iniciativë që vjen si "kërkesë e hershme e biznesit." Por ndryshe nga kjo, Rama dhe mbështetësit e tij po përpiqen, në mënyrë aspak bindëse, ta prezantojnë atë si një nismë në ndihmë të emigrantëve.

Analizë

Amnistia fiskale për emigrantët, një alibi jobindëse

GJERGJEREBARA | BIRN | TIRANË

Përgjatë tre dekadave që nga rënia e komunizmit, qindramijëra shqiptarë kanë emigruar jashtë vendit. Shumë kanë punuar në të zehtë, kanë sjellë para pas në Shqipëri, kanë investuar, kanë ndërtuar shtëpi, kanë bërë biznese, kanë blerë prona. Deri më sot nuk dihet që ndokush të jetë penguar të bëjë diçka të tillë. Dhe as nuk dihet nëse dikush ka hasur ndonjë telash me agjencitë ligjzbatuese për burimin e parave. Në fakt, shqetësimet kryesore të organizatave ndërkombëtare ka qenë mungesa e kontrolleve mbi origjinën e pasurisë së investuar në Shqipëri, pasuri që shpesh arrijnë në rendin e dhjetëramilionë eurove, dhe që dukshëm nuk është produkt i punës në të zehtë të ndonjë kamarieri apo punëtori ndërtimi emigrant në ndonjë vend perëndimor.

Megjithatë, kryeministri Edi Rama dhe mbështetësit e tij po përpiqen, në mënyrë aspak bindëse, të pretendojnë se një nismë e tyre, e shumëkriticuar nga Bashkimi Evropian dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, për legalizimin e parave informale dhe për amnisti penale për poseduesit e këtyre parave, është në fakt një nismë në ndihmë të punëtorit hallexhi që ka punuar në të zehtë.

Rama e prezantoi në këtë mënyrë çështjen e amnistisë në një pyetësor për publikun, i cili nuk dihet se si u plotësua e nga kush u plotësua, por që sipas Ramës, është plotësuar nga qindramijëra vetë të paidentifikuar. Pyetja shtrohet nëse duhet të lehtësohen emigrantët apo jo dhe përgjigjja e popullit është që po, duhet të lehtësohen.

Më tutje, të enjten, Taulant Balla akuzoi kritikët e amnistisë se janë kundër emigrantëve, se duan që atyre t'u nxihet jeta e madje të ndiqen penalisht në rastet kur sjellin kursimet e tyre në Shqipëri.

"Thojeni këtu, jeni kundër? Je kundër që shqiptarët të sjellin paratë nga emigracioni që mos ua nxijë më jetën me histori idiothe ku dhe Policia e Shtetit ndalon një shqiptar që vjen në shpinë e vet brenda asaj shumës së vendosur me ligj e që ligji parashikon që hapi i fundit është të shkosh në ndjekje penale në fakt, se e kemi kaluar këtu ligjin për pastrimin e parave," deklaroi Balla.

As Balla dhe as Rama nuk kanë dhënë ndonjë shembull se kur ndonjë emigrant shqiptar është ndjekur penalisht duke sjellë paratë e tij të kursimeve në Shqipëri.



Kryeministri Edi Rama duke folur gjatë punimeve të Kongresit të Partisë Socialiste. Foto:LSA

Aktualisht është detyrim ligjor për çdo qytetar që të deklarojë se disponon me vete shuma mbi 10 mijë dollarë kur kalon kufirin në hyrje apo në dalje të Republikës së Shqipërisë (dhe të gjitha vendeve tjera normale). Bankat kanë gjithashtu detyrën që të raportojnë rastet kur qytetarët paraqiten në sportel dhe dëshirojnë të depozitojnë shuma të mëdha. Askush nuk ndalon askënd që të sjellë në Shqipëri 1 mijë apo 2 mijë euro herë pas here, dhe as të sjellë në Shqipëri 10 mijë apo 20 mijë euro gradualisht përgjatë viteve.

As Rama dhe as Balla nuk kanë dhënë shpjegime se çfarë shumash ata presin që emigrantët të kenë fituar duke u punësuar në të zehtë dhe që duhet të legalizohen përmes ligjit të tyre. Ata nuk i janë referuar as ndonjë studimi që të sugjerojë se emigrantët e kanë me të vërtetë një problem të tillë. Por ama është vetë relacioni i projektligjit të vitit 2020 i cili shpjegon arsyet e vërteta të nismës së Ramës për amnisti fiskale. Relacioni i publikuar në faqen e internetit të Kuvendit të Shqipërisë [link], nuk përmend asnjëherë fjalën "emigrant". Përkundrazi, arsyet e dhëna në të lidhen vetëm me kompanitë dhe bilancet e kompanive.

"Sqarojmë se ndërmarrja e një iniciative të tillë ka qenë kërkesë e hershme e sipërmarrjeve dhe e organizatave përfa-

qësuese të biznesit," shkruhet në relacion.

Dhe më tutje: "Projektligji synon garantimin e procedurave transparente për të mundësuar ligjësimin e pasurive të padeklaruar dhe/ose të paregjistruara, tërësisht apo pjesërisht, si dhe për rivlerësimin e pasqyrave financiare të subjekteve."

Me pak fjalë, projektligji është kërkesë e organizatave përfaqësuese të biznesit dhe synon, mes të tjerash, rivlerësim të pasqyrave financiare.

Edhe qëllimi i projektligjit, arsyeja se pse qeveria e sheh si të logjikshme ta hedhë këtë hap, nuk lidhet aq shumë me lehtësimin e jetës së emigrantëve se sa me dëshirën për të pasur më shumë para të pista në sistem.

Relacioni thotë se nisma e qeverisë synon të ndihmojë për të kapërcyer pasojat e tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë së koronavirusit të ri.

"...është e nevojshme që, për të tejkaluar këtë situatë dhe për të mbështetur sipërmarrjet në këto kushte të vështira, krahas stimujve fiskalë që janë miratuar dhe do të miratohen në të ardhmen, të krijohen mundësi edhe për legalizimin e kapitaleve dhe pasurive, të cilat, për shkaqe të ndryshme nuk janë deklaruar apo ligjëruar," thuhet në relacion.

Qeveria u detyrua nga presioni ndër-

kombëtar të tërhiqet nga miratimi i këtij projektligji, i cili aktualisht ka statusin "Kthyer nismëtarit", pasi ekspertët ngritën shqetësimin se paratë e krijuara nga aktivitetet kriminale, përfshirë drogën, pastrimin e parave dhe korrupsionin, do të mund të legalizoheshin në këtë mënyrë ndërsa vepra penale e pastrimit të parave do të amnistohesh bashkë me legalizimin e parave.

Projektligji parashikon në mënyrë jo shumë bindëse se politikanët dhe familjarët e tyre të afërt nuk do të mund të përfitojnë, por në kushtet e "familjarëve të afërt" kanë vendosur kriterin e gjendjes civile "në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji." "Gjendja familjare" është familja e regjistruar në zyrat e gjendjes civile dhe ajo ndryshon me kërkesën e të interesuarit në çdo kohë. Vëllai apo motra, p.sh., mund të shkëputet nga trunju familjar i politikanit para hyrjes në fuqi të ligjit të amnistisë dhe të legalizojë sa të dojë paratë e korrupsionit, ndërsa vepra penale e pastrimit të produkteve të veprës penale, të cilën ku person po e kryen duke legalizuar paratë e zyrtarit të korruptuar, amnistohet gjithashtu.

Larg të qenit një nismë në ndihmë të emigrantëve, amnistia fiskale e Ramës ka shumë gjasa që të jetë një legalizim i krim-it dhe i korrupsionit të sotëm të Shqipërisë.

Presidenti francez Emmanuel Macron u rizgjodh sepse arriti të prezantohej si mishërimi i një administratori efikas dhe kompetent. Por zgjedhjet treguan gjithashtu se më shumë votues se kurrë duan që sistemi të hidhet në erë, jo të menaxhohet më mirë.

Fitorja e Macron s'është humbje e populizmit

YANIS VAROUFAKIS
| PROJECT SYNDICATE |

Rizgjedhja e presidentit francez Emmanuel Macron me një diferencë komode përballë një kundërshtarëve me të cilën ai ndan një mospëlqim të ndërsjellë, pothuajse errësoi njëfarë bashkëvarësie midis kampeve të tyre politike. Macron dhe kundërshtarja e tij, Marine Le Pen, mund ta urrejnë njëri-tjetrin, por ata kanë zhvilluar një lloj simbioze politike që ofron njohuri thelbësore për situatën aktuale në Francë, Evropë dhe më gjerë.

Spektri i një fitoreje të Le Pen ka mbajtur një traditë për të ndihmuar pushtetarët të kthehen në Elysee. Para Macron, 20 vjet më parë, Jacques Chirac mori 82% të votave kundër babait të Le Pen, Jean-Marie Le Pen.

Por këtë herë ishte ndryshe. Në vitin 2002, frika nga Jean-Marie Le Pen solli triumfin e Chirac. Në vitin 2022, ishte më shumë një rrugë e dyanshme: ndërsa Le Pen sigurisht e ndihmoi Macron të mblidhte një shumicë të qartë votuesish, Macron gjithashtu forcoi Le Pen. Rezultati flet vetë: një ultra e djathtë fitoi 42% të votave. Gjatë pesë viteve të fundit, bashkëvarësia Macron-Le Pen u rrit, dhe jo përkundër antipatisë së ndërsjellë të dy kundërshtarëve, por të paktën pjesërisht për shkak të saj.

Rizgjedhja e Chirac në vitin 2002 u ndërtua mbi një koalicion të së djathtës, qendrës dhe të majtës kundër ultra të djathtës ksenofobike. Pesë vjet më parë, i përballur edhe një herë me të njëjtin kërcënim të ekstremit të djathtë, Macron nuk u paraqit as i majtë as i djathtë. Kjo funksionoi, vetëm se tepër mirë: mantra as e majtë dhe as e djathtë e Macron infektoi mendimin e atyre që e kundërshtojnë atë më ashpër.

Të rinjtë, prekariati dhe segmentet gjithnjë e më të pasigurta të proletariatit refuzojnë të vlerësojnë kandidatët presidencialë në kuptimin e ndarjes majtas, djathtas. Ata shohin një Francë të sunduar nga një botë e huaj parash, e cila jo vetëm që i ka lënë pas, por i mban aktivisht atje. Në sytë e tyre, Macron mishëron atë botë. Për ta, ndarja e re politike është midis politikanëve të respektuar që premtojnë se do ta ruajnë këtë botë dhe atyre që zotohen se do ta shkatërrojnë atë.

Në debatin televiziv parazgjedhor mes dy kandidatëve, Macron arriti të prezantohej si mishërimi i administratorit efikas,

kompetent, i cili e kuptonte sistemin dhe mund ta menaxhonte më mirë atë. Por kjo nuk u bën përshtypje votuesve që duan që sistemi të rrëzohet, jo të menaxhohet më mirë.

Qasja e Macron më kujtoi kundërshtarët e Brexit në Britani, të cilët nuk arritën të parashikonin mentalitetin e votuesve pro Brexit. Sa më shumë që u thuhej këtyre votuesve, me grafikët dhe statistikën, se Brexit do t'i bënte ata të vu-anin, aq më shumë emocionoheshin ata për perspektivën e sakrificave kolektive për të rrëzuar një sistem që ata besonin se ishte manipuluar kundër tyre.

Duke iu rikthyer krahasimit me zgjedhjet e vitit 2002 në Francë, ka një ndryshim të madh midis koalicionit të spektrit që mbështeti Chirac dhe mantrës radikale të Macron-it as të majtë e as të djathtë. Njëzet vjet më parë, votuesit e majtë mbështetën një politikan të krahut të djathtë për të mbajtur larg Le Pen. Chirac e kuptoi se vota e tyre ishte huazuar nga forca politike si Partia Socialiste dhe Partia Komuniste. Ndryshe nga kjo, në vitin 2017, Macron ia doli të eliminonte partitë e së majtës dhe të djathtës përpara se të thërriste spektrin e Le Pen për të dominuar plotësisht.

Pasi në pallatin Elysee, dhe me një shumicë absolute në Asamblenë Kombëtare, Macron vazhdoi të ndiqte axhendën e tij pa angazhimet që kishin ankoruar Chirac-un, i kufizuar vetëm nga kufizimet e Financave të Mëdha dhe një Bashkimi Ev-

ropian shtrëngues që i përkiste interesave të biznesit. Brenda pak vitesh, ai ia doli ta bënte Parisin më miqësor ndaj biznesit, duke rigjallëruar skenën franceze të start-up-ëve dhe duke ulur shkallën zyrtare të papunësisë.

Por prekariati u zgjerua. Shumë votues panë perspektivat e tyre të zvogëloheshin si pasojë e drejtpërdrejtë e politikave që u dukej se përbënin një luftë klasore të hapur kundër tyre personalisht: taksa në favor të të pasurve tashmë ultra të pasur, çrregullim i pushimeve nga puna, një taksë regresive për karbonin dhe një vendosmëri për të rritur moshën e pensionit në mënyrë të konsiderueshme në një vend ku jetëgjatësia e burrave të varfër është 13 vjet më e ulët se ajo e burrave të pasur.

Ky realitet u bë themeli i reagimeve reciproke përforcuese midis veprës politike të Macron dhe Le Pen. Ndërkohë që nuk ka bashkëpunim – ata kanë alergji nga njëri-tjetri – dinamika mes tyre formon një ngërç politik që lehtëson një lloj të ri akumulimi kapitali për një klasë të re në pushtet. Macron përfundimisht i shërben asaj klase dhe sundimi i tij kur një si Le Pen është opozita zyrtare.

Asgjë nga sa më sipër nuk duhet të interpretohet si ngurrim për të mbajtur anë. Pesë vjet më parë, i bëra thirrje kujtdo që do të dëgjonte të votonte për Macron kundër Le Pen.

Këtë vit, edhe pse DiEM25 (lëvizja së cilës i përkas) vendosi të bëjë të njëjtin rekomandim për anëtarët tanë francezë, kjo

rezultoi më e vështirë. Efekti i reagimit Macron-Le Pen ka ngushtuar hapësirën që dikur i ndante ata për çështjet e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit bazik. Si mund të harrojmë Gerald Darmanin, ministrin e brendshëm të Macron, i cili vitin e kaluar denoncoi Le Pen se po tregojte "shumë e butë ndaj emigracionit"?

Politikanët e stilit Macron po dështojnë kudo të ngrihen në mbrojtje të racionalizmit liberal që pretendojnë se mbrojnë. Duke u fshehur pas narrativës së tyre as të majtë e as të djathtë, ata mbështetën kombinimin irracional të masave shtrënguese dhe paketave të shpëtimit të bankave që sollën 12 vjet amulli, duke parandaluar investimet serioze në energjinë e gjelbër. Gjatë pandemisë, ata u përkulën para shkeljeve të pakuptimta të të drejtave civile. Sot, ata demonizojnë të moderuarit që paralajmërojnë kundër përshkallëzimit të konfliktit NATO-Rusi dhe që mbështesin një marrëveshje midis Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë që lejon një Ukrainë neutrale të hyjë në BE, por e mban atë jashtë NATO-s.

Morali i rizgjedhjes së Macron është se, në shoqëritë e mbushura me klasa, ndarja majtas-djathtas mbetet thelbësore. Kur politikanët centristë arrijnë ta errësojnë atë, ata ngecin në një qark dinamik me ultra të djathtë që i bën ata të duken më të mprehtë dhe më irracionalë, ndërkohë që e bën ultra të djathtët të duket në mënyrë mashtruese më e këndshme. Edhe ku fitojnë, ata humbin.



Marine Le Pen dhe Emmanuel Macron. Foto: Youtube Screenshot.

ANALIZË

Adhurimi ndaj Edi Ramës ngre shqetësime për krijimin e “kultit të individit”

Krijimi i një narrative politike servile dhe fetishiste, si dhe përdorimi i mjeteve të propagandës për shpërndarjen e saj shihen me shqetësim nga ekspertët e komunikimit.

BLERINA GJOKA | BIRN | TIRANË

Në fillim të muajit mars, në median online, qarkulloi një deklaratë e Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Edona Bilali, ku ajo shprehej se kryeministri Edi Rama ishte në rrugën e duhur për t'u bërë si Zeusi – zoti i qiellit në mitologjinë e lashtë greke.

“Zoti Rama vërtetë nuk është Zeusi, por unë do e perifrazoja nuk është akoma Zeusi, por është në rrugën e duhur, pasi përveç pjesës që ai ka në staf dhe në qeveri është edhe opozita me qëndrimet e ditëpasditshme, është duke dhënë dhe ajo kontributin e vet që me pas një Zeus” – citohet Bilali, në një fjali komplekse dhe logjikisht të trazuar.

Pas publikimit të deklaratës, ministrja sqaroi se ky pohim ishte bërë në vitin 2017, kohë kur ajo militonte në radhët e shoqërisë civile.

Shpjegimi nuk e pengoi krahasimin e pazakontë të bëhej viral, për shkak të ngjashmërisë së pohimit të Bilalit me të tjera deklarata mitizuese nga socialistët për liderin e tyre. Këto deklarata, sipas ekspertëve, kanë krijuar ndër vite një narrativë komunikimi me publikun që duket se përpiqet të ndërtojë “kultin e individit” – një fenomen që i ka rrënjët në kulturën e regjimeve autoritare.

Edhe pse epitetet dhe krahasimet që vartësit politik i bëjnë Ramës janë hiperbolizuese, vetë kryeministri i pëlqen t'i përdorë në kontekste të ndryshme.

Gara e elozheve ndaj Ramës u hap në vitin 2017 nga Ministria e Shtetit për Parlamentin, Elisa Spiropali, e cila e krahasoi shefin e saj socialist me heroin tonë kombëtar Skënderbeun – i shpallur nga Papa si ‘Atelet i Krishtit’.

Deklarata e Spiropalit u pasua nga vlerësime të ngjashme të deputetëve dhe ministrave socialistë.

Ministri i Brendshëm, Blendi Çuçi madje i veshi Ramës veti mbinjerëzore gjatë një komunikimi për problemet e pronë-

sisë me fermerët në jug të vendit.

“Katrahurën që është bërë me pronësinë në këtë vend nuk ka tokësor që ta zgjidhi, përveç Edi Ramës...” – tha ai.

Ndërsa një tjetër ministre socialiste, Milva Ekonomi, duke shprehur admirimin e saj për shefin, e cilësoi atë një markë ndërkombëtare.

“Unë shumë shpesh mendoj që nëse ka një ‘brand’ aktual Shqipëria përtej kufirit, unë mendoj që brandi që ka Shqipëria sot quhet Edi Rama” – u shpreh Ekonomi në një takim me studentë në Universitetin Europian të Tiranës disa vite më parë.

“Në çdo takim ndërkombëtar që kemi shkuar, nga diskutimet që bën, tezat që ngre për diskutim, të bën shumë përshypje, sepse është nga ata njerëzit që globin e ka te koka” – shtoi ajo.

Gjatë fushatës së fundit elektorale për zgjedhjet parlamentare – para se të dorëhiqej nga politika, edhe Gramoz Ruçi iu bashkua kësaj narrative duke e cilësuar Ramën lider të pakonkurrueshëm.

“Nuk ka konkurrent tjetër, është ai i pari e janë shumë vende bosh” – deklaroi Ruçi, i cili nuk njihet si një orator i hollë.

Adhurimi semantik për vetitë e liderit të Ramës shkon përtej Kuvendit dhe kabinetit qeveritar.

“Është ndërë dora e Edi Ramës, si dora e Zotit” – deklaroi kryebashkiaku i Kamzës, Rakip Suli, pas tërmetit shkatërrimtar të vitit 2019.

Kolegu i tij nga Tepelena, Tërmet Peçi, i drejtohej Ramës gjatë takimeve publike si “komandant”, duke bërë një analogji të dukshme me ish-diktatorin Enver Hoxha – Komandant i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ekspertët e shohin me habi këtë fenomen që sipas tyre mbart ngjashmëri me të shkuarën autoritare të vendit por edhe elementë të komunikimit modern politik.

Për ekspertin e komunikimit, Edlira Gjoni, thurja e lavdeve dhe krahasimet publike me figura apo simbole të admiruara, janë baza e ngritjes së kultit të individit në politikë.



“Vjen e trishtë e gjitha kjo përpjekje masive e ministre për të ushqyer në publik figurën e idhullit, imazhin e heroit e atë të liderit që triumfon, edhe pse sulmohet nga të gjithë” – u shpreh ajo.

Për Ermal Hasimen, ekspert i Shkencave Politike dhe Komunikimit, glorifikimi i liderit politik nga mbështetësit nuk është një proces i padëgjuar për politikën bashkëkohore.

“Qendërzimi i vëmendjes së individit në politikën bashkëkohore është pjesë e një procesi normal thjeshtëzimi në minimumin e nevojshëm të komunikimit dhe përfaqësimit” – shpjegoi ai.

Sipas Hasimes, këto qëndrime janë më tepër për konsum të brendshëm brenda partisë dhe për aq sa i drejtohen publikut synojnë më tepër zgjedhësin e majtë. Ai e sheh këtë fenomen gjithashtu të lidhur me traditën popullore të sjelljes ndaj figurave politike në Shqipëri.

“Udhëheqësit e partive kryesore në Shqipëri kanë këngë në emrin e tyre, të bëra jo nga ministra por nga mbështetës të tyre të thjeshtë” – theksoi ai.

Me mentalitetin shoqëror dhe mungesën e emancipimit politik e lidh këtë fenomen edhe Skënder Minxhozi, analist i politikës, sipas të cilit, krahasimet që i bëhen Ramës nga socialistët janë komike dhe nuk duhen marrë seriozisht.

“I pari që tallet e ironizon me këtë gjë është vetë Rama” – tha Minxhozi duke shtuar se “kemi të bëjmë me një deformim social që e tejkalon këtë rast konkret”. “Mesa duket duhet edhe shumë kohë që ne shqiptarët të demistifikojmë drejtuesit e vendit dhe ky është një proces emancipimi që do të marrë kohë” – shtoi ai.

Edhe për Gjonin këto deklarata janë në kufijtë e qesharakes, pasi ngajnë me metodat primitive të propagandës së kohës së diktaturës.

“Ndryshe nga ajo kohë kur mezi kishte radio për të dëgjuar liderët, sot gjithkush i sheh, i dëgjon, i verifikon ato që thotë lideri, ndaj edhe përpjekjet e ministrave për ta bërë Ramën Skënderbe e Zeus, tingël-

lojnë dëshpërimisht qesharake” – gjykoj ajo.

Trashëgimia nga diktatura

Shqipëria si një vend ish-komunist ka vuajtur nga “kulti i individit”, ku udhëheqësi nëpërmjet propagandës kishte krijuar një imazh të idealizuar të vetes, ndërsa ushtronte të gjitha pushtetet dhe kontrollonte jetën e qytetarëve.

Profesor Daniel Ursprung, studiues i sistemeve diktoriale, ngre shqetësimin për rolin që luan media në krijimin e kultit të individit në vendet me të shkuar komuniste. “Kurrë nuk duhet lënë një lider që të bëhet shumë i fuqishëm. Duhet ushtruar parimi i demokracisë “check and balance” – kontroll dhe ekuilibër. Nuk ka një person apo një institucion të vetëm që të ketë të gjitha pushtetet. Përkundrazi, në demokraci pushtetet nuk i ushtron një njeri i vetëm dhe as një institucion i vetëm. Është shumë i rëndësishëm roli i shoqërisë civile dhe i medias për të vëzhguar se çfarë po bën qeveria, për të kritikuar në kuptimin pozitiv të fjalës kultin e individit. Pikërisht ky është mësimi i madh që jep e kaluara” – shprehet Ursprung për radion Deutsche Welle.

Sipas Gjonit narrativa e kultit të individit është shumë e rrezikshme në shekullin e XXI. Sipas saj, pikërisht në këtë drejtim, PS-ja në pushtet po përdor teknika që nuk janë aspak demokratike.

“Socialistët përdorin ende teknikat e masmedias, propagandës, gënjeshtre – pa ua bërë syri tërr, lajmet e rreme, spektaklet, koncertet masive, keqpërdorimin e artit, frikës, të pseudo-dashurisë e kujdesit për njerëzit e për popullin” – tha ajo.

Të gjithë këto teknika të specialistëve socialistë janë metoda që përdoren nga vende si tonat – me vetëm një parti, pa opozitë, me shtet të dominuar nga partia në pushtet, jo nga ligji në fuqi, me tipare totalitarizmi e autokracie” – shtoi Gjoni.

Hasimja thekson se për shqiptarët krijimi i kultit të individit është një dukuri më e hershme se koha e komunizmit.

Biznes dhe politikë pas investimeve hungareze në Shqipëri

Me tre blerje të mëdha në pak muaj, vala e shpenzimeve hungareze në Ballkanin Perëndimor ka mbërritur më në fund në Shqipëri.

FJORI SINORUKA | BIRN | TIRANË

Që kur Viktor Orban u bë kryeministër në vitin 2010, firmat hungareze – disa prej tyre të lidhura me partinë Fidesz në pushtet të Orbanit dhe duke përfutur shumë nga kontratat fitimprurëse shtetërore – kanë investuar shumë në Slloveni, Serbi, Maqedoninë e Veriut, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci.

Tani ata po vërshojnë edhe drejt Shqipërisë, ku në fund të vitit të kaluar 4iG rrëmbeu ofruesit e dytë dhe të tretë më të mëdhenj të telekomunikacionit në Shqipëri – ONE Telecommunications dhe ALBtelecom – dhe grupi bankar OTP bleu filialin shqiptar të Alpha Bank të Greqisë.

Sipas të dhënave nga Instituti i Statistikeve, numri i kompanive të zotëruara pjesërisht ose plotësisht nga kapitali hungarez është më shumë se dyfishuar midis 2016 dhe 2020. Vlera e investimeve hungareze u rrit 37 herë midis fundit të 2018 dhe fundit të 2021, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë të cituara nga e përditshmjat shqiptare e biznesit Monitor.al.

Më 4 mars, 4iG njoftoi se kishte përfunduar blerjen nga Cetel Telecom turk të 80.27 për qind të aksioneve të ALBtelecom, duke e transformuar efektivisht tregun e telekomunikacionit fiks dhe celular të Shqipërisë në një duopol midis 4iG dhe Vodafone. Shumica e aksioneve të 4iG, i cili ofron shërbime IT, përfshirë menaxhimin e pajisjeve dhe sistemeve në Hungari, është në pronësi të aleatit të Orban, Gellert Jaszai, i cili ia bleu ato manjatit hungarez dhe mikut të fëmijërisë Orban, Lorinc Meszaros, në 2019.

Nën Meszaros, kompania shënoi rritje të shpejtë të të ardhurave në kurriz të një sërë kontratash shtetërore; vlera e saj e tregut është rritur pothuajse 25 herë që kur Jaszai mori drejtimin, sipas Bloomberg, përsëri kryesisht falë projekteve shtetërore. I përjashtuar nga rregullat kombëtare të konkurrencës për “shkrirjet strategjike” që konsiderohen të një rëndësie kombëtare, 4iG ka rrëmbyer kompani në një sërë sektorësh, nga Inteligjenca Artificiale deri tek Blockchain.

Peter Krasztev, një profesor i asociuar në Shkollën private të Biznesit të Budapestit, BBS, tha se firmat hungareze kishin zakon të hynin në tregje ku kompanitë perëndimore hezitojnë të investojnë “për shkak të klimës specifike të korrupsionit, marrëdhënieve fisnore, mbizotërimit politik”.

Por, shtoi ai, “çdo zgjerim ndërkombehtar i kompanive hungareze është disi i lidhur me klanin Orban”.

Shqipëria një shënjestër “logjike” për investimet hungareze

Në qershor të vitit të kaluar, pasi fitoi një mandat të tretë të paprecedentë, kryeministri Edi Rama vizitoi Hungarinë në krye të një delegacioni që përfshinte katër min-

istra kabineti dhe kryebashkiakun e Tiranës, Erion Veliaj.

Pesë muaj më vonë, të dy vendet nëshkruan një marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi ekonomik, njësoj si dhe dhomat e tyre të tregtisë dhe industrisë, me synimin për të rritur investimet hungareze në Shqipëri.

Blerjet e 4iG ishin tashmë në punë e sipër, ndërsa në dhjetor OTP, banka më e madhe tregtare e Hungarisë, pagoi 55 milionë euro për filialin shqiptar të Alpha Bank të Greqisë. Përveç blerjes së Societe Generale Albania në vitin 2018, pjesa e tregut e bazuar në asete e OTP tani do të arrijë në rreth 11 për qind.

Duke përshëndetur marrëdhëniet në rritje të investimeve, Nikolën Jaka, kreu i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, tha se OTP do të shërbejë si “një urë lidhëse midis Hungarisë dhe Shqipërisë, duke u mundësuar bizneseve hungareze të gjejnë terrenin më të përshtatshëm për investimet e tyre në Shqipëri”. “Kompanitë hungareze e shohin padyshim praninë e OTP Bank në Shqipëri si një çështje besueshmërie”, tha Jaka për BIRN. Elvin Meka, dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në Universitetin Europian të Tiranës, tha se blerjet e fundit hungareze në Shqipëri pasqyrojnë ambicien “realiste dhe pragmatike” të firmave për t’u zgjeruar ndërkombehtarisht dhe rajonalisht.

Duke pasur parasysh mungesën e interesit nga vendet më të mëdha dhe më të zhvilluara evropiane, tha ai, është e natyrshme që firma nga vendet më pak të zhvilluara të Bashkimit Evropian “të kërkojnë të hyjnë dhe të zgjerohen në tregun shqiptar”. Tregu i Ballkanit Perëndimor është një vend më i lehtë për të konkurruar. “Këto biznese e kanë shumë të vështirë të konkurrojnë drejtpërdrejt në vendet e mëdha të BE-së dhe për rrjedhojë e vetmja mundësi e tyre për zgjerim të shpejtë dhe krijimin e ekonomive funksionale të shkallës do të jenë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe logjikisht Shqipëria”, tha Meka.

Lidhjet politike përkthehen në investime

Hungarezët do të zhvillojnë zgjedhjet parlamentare në prill dhe partia Fidesz e Orbanit parashikohet të fitojë një mandat tjetër në qeveri, pavarësisht presionit nga një bllok i bashkuar opozitar. Mbështetësi i vetëshpal-

lur i “demokracisë joliberalë” ka krijuar aleanca me liderë me të njëjtin mendim në të gjithë rajonin, nga Aleksandër Vuçiç i Serbisë dhe Janez Jansa i Sllovenisë deri te ish-kryeministri maqedonas Nikola Gruevski, i cili në 2018 u arratis për t’i shpëtuar dënimit me burg dhe mori azil në Hungari.

Dhe aty ku lidhjet politike janë të ngrohta, sigurisht që vijnë edhe investimet hungareze. “Aty ku liderët autoritarë dhe mbështetësit e Orbanit janë në pushtet, hyn menjëherë në skenë biznesi hungarez”, tha Krasztev, i cili citoi gjithashtu shembullin e Bullgarisë kur Boyko Borissov ishte kryeministër. Një diplomat hungarez me përvojë, i cili foli në kushte anonimiteti, tha për BIRN: “Orban kohët e fundit ka investuar shumë, jo vetëm si Hungari, por përmes një biznesmeni privat shumë afër tij, le të themi. Nga Sllovenia në Serbi, Maqedonia e Veriut, Bosnje dhe Kroacia, ata po investojnë shumë para.” Diplomati i përshkroi marrëdhëniet midis Serbisë dhe Hungarisë nën udhëheqjen e Vuçiç dhe Orban si “shumë, shumë të mira” dhe tha se Orban kishte gjithashtu “kimi të mirë” me Jansën dhe liderin serb të Bosnjës Milorad Dodik. Po Rama i Shqipërisë?

“Marrëdhëniet midis Orbanit dhe Ramës janë krejtësisht ndryshe”, tha ai. “Është diçka e ngjashme me Budapestin dhe Zagrebin, ju e dini që ata kanë interesa të përbashkëta, por mes tyre nuk ka dashuri.”


Një shpenzim i tillë në rajon blen ndikimin e Orbanit, tha diplomati për BIRN.

Por ndërsa investimi nga kompani si 4iG ose kompani të tjera afër Orbanit mund të jetë ad hoc, “me Csanyi dhe OTP është tjetër histori”, tha ai, duke iu referuar kryetarit dhe shefit ekzekutiv të OTP, Sandor Csanyi. “Është një strategji afatgjatë.” Në mes të shkurtit, OTP Group tha për Monitor.al se prania e saj ka të ngjarë të inkurajojë firmat hungareze të bëjnë më shumë biznes në Shqipëri, me OTP-në që vepron si partnere në financimin dhe konsulentin e biznesit. Banka tha se kishte identifikuar mundësi investimi në infrastrukturë, bujqësi, ushqim dhe turizëm.

Csanyi nuk iu përgjigj kërkesave të BIRN për koment.



Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama me kryeministrin e Hungarisë Viktor Orban. Foto: Zyra e Kryeministrit.



Kulti i individit | Ilustrim grafik nga BIRN/Jurgena Tahiri

“Duket sikur vërtetohet ai kompleksi i famshëm i Edipit përmes këtij roli të babait si model i plotfuqisë dhe njëkohësisht babait të urryer që duhet përmbysur”- shpjegoi ai.

Hasimja nënvizoi se në komunizëm kulti i individit mbështetet te frika nga udhëheqësi, ndërsa në ditët e sotme, kulti i individit i shërben më tepër ngjitjes së shkallëve në karrierë. Ai theksoi se ka një dallim kryesor mes imazhit të udhëheqësit në një demokraci normale dhe imazhit të tij në “pothuajse-demokracinë” shqiptare.

“Në Perëndim udhëheqësi përpigjet të duket kryesisht si ‘njëri nga ne’ duke shfaqur aftësi më të arrira se njeriu i zakonshëm, ndërsa në Shqipëri udhëheqësi përpigjet të portretizohet si dikush i jashtëzakonshëm, që herë pas herë i lejon vetes të duket si ‘njëri nga ne’”- tha ai.

Sipas Hasime, kjo kontradiktë me Perëndimin vjen kryesisht nga fakti se udhëheqësi ka një pushtet të jashtëzakonshëm mbi jetën e individit në Shqipëri.

“Shpesh udhëheqësi mund të ndërhyjë për një vend pune a një favor tjetër të ngjashëm që i ndryshon jetën votuesit individual” – tha ai.

“Në një demokraci normale kjo është e pamundur dhe votuesi individual angazhohet për shkak të bindjeve e jo për përfitime personale”- përfundoi Hasimja.

Ndërsa Minxhozi e sheh narrativën që prodhon kultin e individit si një fenomen pa kohë dhe pa sistem ideologjik.

“Natyrisht komunizmi prodhoi një kult individuali të skajshëm tek figura e Enver Hoxhës dhe byroistëve të tjerë të kohës, por në përgjithësi gjykoj se servilizmi dhe fetishizimi janë fenomene që i tejkalojnë periudhat e caktuara historike”- tha ai.

Sipas Minxhozit, më shumë sesa e rrezikshme, narrativa e socialistëve tregon “pajjekuri dhe mosdalje nga cikli i tranzicionit dhe i demokracisë hibride”.

Minxhozi mendon se ky është një fenomen që dëshmon “nevojën urgjente për rotacionin dhe freskimin e elitës politike në vend”.

INVESTIGIM

E anashkalar, e pandëshkuar: Dhuna ekonomike në Ballkan

Dhuna ekonomike ndaj grave në Ballkan është e përhapur, por shpesh kalon pa u vënë re dhe pothuajse gjithmonë e pandëshkuar. Pasojat janë të thella.

VANJA NESKOVIC, DRAGANA PRICA KOVACEVIC | BIRN | NOVI SAD

Adina shpjegon se paratë që i duhen i merr nga i shoqi. “Dhe gjithmonë më duhet të shpjegoj pse më duhet diçka kur e blej... Ndonjëherë, me kuptimin e plotë të fjalës, i lutem të më japë paratë”, tha ajo.

Adina, e cila kërkoi të mos identifikohet me emrin e saj të vërtetë, ishte në shkollë në Bosnje dhe Hercegovinë kur mbeti shtatzënë në vitin 2014. Ajo e la shkollën dhe u martua. Tani, ajo thotë se nuk është as e sigurt se çfarë pune do mund të bënte. Atë pak punë që u përpoq të bënte nga shtëpia, në internet, e kundërshtoi i shoqi, duke e akuzuar se kalonte shumë kohë në internet dhe komunikonte me “të huaj”.

Ndërkohë, bashkëshorti i Adinës ka në dorë frerët dhe madje i mban shumë fort.

“Dhe shpesh, kur zihemi, ai nuk më jep asgjë për një javë dhe unë s’kam si t’i blej ushqimet dhe produktet higjienike bazë. Ndonjëherë më duhet të marr hua nga fqinja ime për të blerë peceta higjienike.”

Po familja e saj? “Ata e dinë. Sigurisht që e dinë. Ata thonë ‘Hesht dhe duroje, është burri jot.’ Ata thonë se isha unë që e zgjodha; të paktën ai nuk më rreh... Nëna ime ka vuar të njëjtën gjë.”

Mund të tingëllojë ekstreme, por rrëfimi i Adinës nuk është aspak i pazakontë në Ballkan, ku dhuna ekonomike shumë shpesh kalon pa u vënë re në shoqëritë kryesisht patriarkale, ku gratë shpenzojnë dy herë më shumë kohë duke bërë punë të papaguar sesa burrat dhe përbëjnë një pjesë disproporcionale të madhe të popullsisë së papunë.

Në një anketim me 680 gra në Serbi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, 101 thanë se debatonin me partnerët e tyre për para. Sipas përgjigjeve të tyre, shkaktarët kryesorë janë mungesa e parave, akuzat për shpenzime të tepërta të ngritura nga partneri mashkull dhe mungesa e vlerësimit për punët e shtëpisë që bën partnerja femër.

Më shumë se 10 për qind e grave raportuan se shpenzonin më pak se 20 euro në muaj për nevojat e tyre personale. Gjysma e këtij numri janë të punësuar. Më shumë se 30 për qind thanë se shpenzojnë më pak se 50 euro në muaj për veten e tyre.

Megjithatë, rreth 56 për qind thanë se nuk ishin në dijeni se dhuna ekonomike dënohet me ligj në të dy vendet, megjithëse rastet e regjistruara janë pothuajse inekzistente.

“Problemi është se shumë shpesh nuk ka ndalime dhe kërcënime të qarta. Të paktën në fillim të një marrëdhënieje, ajo mund të mbështillet me një ide dashurie dhe kujdesi, e cila më vonë mund të tregojë fytyrën e saj të vërtetë kur një grua nuk mund të bëjë më asgjë pa lejen e partnerit të saj”, tha sociologja Jelena Riznic, anëtare e rrjetit “Solidariteti Femër” në Serbi.

“Fillon me gjëra të zakonshme si ato që ajo do të blejë për në shtëpi, për veten e kështu me radhë, dhe përfundon në situata ku ajo nuk mund të largohet nga marrëdhënia sepse teknikisht nuk ka asgjë dhe nuk mund të jetojë e pavarur sepse ajo është e varur financiarisht prej tij.”

Viktimat bëhen të besojnë se janë “të paafta për punë”

Dhuna ekonomike manifestohet në tre mënyra, thotë Medina Mujic nga fondacioni feminist-aktivist “CURE” në Bosnje.

Së pari, një grua është e varur financiarisht nga burri i saj, “që do të thotë se ajo nuk ka të ardhura të veta dhe varet nga partneri për çdo nevojë apo dëshirë materiale”.

Së dyti, një grua mund të punësohet dhe të kontribuojë në buxhetin e familjes, por me një normë të caktuar nga partneri mashkull, në mënyrë që “gruaja të mos ketë plotësisht kontrollin e parave të saj”.

Dhe së treti, kur partneri mashkull “saboton” punën e gruas, “duke ardhur gjatë gjithë kohës në vendin e saj të punës, duke e shqetësuar gruan me telefonata, por shpesh, në kë-

to situata, duke shqetësuar bashkëpunëtorët dhe kolegët me kërcënime, duke shkaktuar telashe.”

Një sjellje e tillë “është shumë e pranishme” në rajon, tha Jasmina Buljic, psikologe në Fondacionin e Demokracisë Lokale, e cila drejton një strehë në Sarajevë.

Kjo “e çon atë person në një pozicion të varur”, tha Buljic për BIRN, “në të cilin ajo beson se është e paaftë për punë, duke besuar atë që dhunuesi i saj e bën atë të besojë.”

Sipas të dhënave të fundit zyrtare, gratë përbëjnë më shumë se 55 për qind të të papunëve në Serbi; në Bosnje, ato përbëjnë rreth 58 për qind të të papunëve që kërkojnë punë.

Gratë shpenzojnë dy herë më shumë kohë duke bërë punë të papaguar sesa burrat, punë që arrin në afërsisht 15 për qind të prodhimit ekonomik kombëtar të Serbisë, ose 6.37 miliardë euro. Për shumë nga këto gra, punët e shtëpisë janë turni i dytë.

“Ai e bën këtë që të jetë superior”

Marija, e cila përsëri kërkoi të mos identifikohet me emrin e saj të vërtetë, është një mësuese anglishteje online. Partneri i saj është avokat. Ajo nuk e di se sa fiton ai, ndërsa ai ushtron pothuajse kontroll total mbi të ardhurat e saj.

“Kjo filloi spontanisht”, tha ajo. “Sinqerisht, herën e parë më bezdisi kur më mori gjysmën e rrogës dhe kur thashë se nuk do të kem mjaftueshëm derisa të marr rrogën muajin tjetër, ai më tha ‘përpiku, do t’ia dalësh.’ Atëherë kjo më shqetësoi vërtet. Dhe më shqetësoi që nuk jemi të barabartë.”

“Sapo mora çekun tim të parë, ai tha se



kishim disa borxhe për të larë.”

Marija, e cila ishte një nga të anketuarit në sondazhin e BIRN, e përshkroi sjelljen e partnerit të saj si një formë dhune psikologjike.

“Kam ndjesinë se ai po e bën për të qenë superior... Se po bën shpenzime vetëm që të mos kem unë para. Mendoj se ai nuk është i lumtur për mua sepse ia dola dhe sepse fitoj më shumë para se ai... Mendoj se ai ka frikë dhe se kjo është një formë manipulimi.”

Nada Padejski, drejtoreshë e një strehe për gratë në Sremska Kamenica, Serbinë veriore, tha se dhuna me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën ekonomike, shpesh i ka rrënjët në dëshirën e dhunuesit për të “izoluar viktimën dhe për të pasur dominim, pushtet të plotë dhe kontroll mbi të, sjelljen dhe jetën e saj”.

Megjithatë, shpesh dhuna ekonomike nuk njihet. “Bazuar në përvojën 15 vjeçare, nëse do të pyesim viktimat dhe autorët, besoj se viktimat nuk do ta kuptonin se ajo që po ndodh me to është dhunë ekonomike dhe definitivisht nuk do ta quajnë kështu, por ato e kuptojnë se të drejtat janë të rrezikuara”, tha Padejski. “Një grua e di gjithmonë kur dikush është i dhunshëm ndaj saj... Autori patjetër do ta mohonte që ai është i dhunshëm. Ai do të minimizonte se çfarë është dhuna ekonomike.”

Normat e trashëguara shoqërore dhe ndikimi psikologjik

Normat patriarkale në Ballkan janë të rrënjësura thellë dhe shpesh propagandohen nga deklaratat e bëra dhe politikat e ndjekura nga liderët politikë. “Kur gratë u bënë të pavarura financiarisht dhe filluan të fitonin paratë e tyre dhe të ishin aktive në jetën publike, pati një çekuilibrë, ku e gjithë shoqëria humbi një model sjelljeje”, tha Mujic.

“Deri atëherë, ata e dinin. Këto ishin normat e sjelljes që trashëgojmë nga një brez në tjetrin, nga prindërit, stërgjyshërit, gjyshet...”

“Ne jetojmë sipas normave patriarkale. Jetojmë në një shoqëri që është në një shoqëri të pabarabartë, në një shoqëri burrash.”

Kjo bën që shumë gra të mbeten në marrëdhënie abuzive jo vetëm për arsye financia-



Rezultatet e një sondazhi online të kryer nga BIRN. Infografika: BIRN/Igor Vujcic.



Ilustrimi: BIRN/Igor Vujcic.

nga një strehë. Pastaj janë çështjet e të drejtave pronësore dhe kompensimi.

“Një grua e cila e ka kaluar tërë jetën e saj duke punuar, duke ndërtuar një shtëpi apo apartament dhe jetën familjare, pas përvojës së dhunës, duhet të mbështetet në fillimin e procedurës pronësore dhe marrjen e pronës që i takon ligjërisht”, tha Padejski.

“Viktimat e dhunës në familje rrallë e bëjnë këtë. Ato zakonisht ia mbathin dhe nisin vetëm procedurat që duhet të bëjnë.”

Qeveritë dërgojnë mesazhe “të rrezikshme”

Ekspertët ankohen për vëmendjen, ose mungesën e saj, që i kushtojnë politikanët çështjes së dhunës ekonomike në një rajon ku qeveritë janë shumë më të preokupuara për të ndryshuar një rënie të numrit të lindjeve.

Ndërsa i drejtohej parlamentit në qershor 2021, presidenti serb Aleksandër Vuçiq tha: “Nuk e di sa duhet të paguajmë që dikush të lindë një fëmijë. Nëse është e nevojshme, ne do ta bëjmë këtë.”

Vuçiq madje ka premtuar stimuj për studentet që mbeten shtatzënë për ta mbajtur fëmijën duke hequr afatet e zakonshme të provimeve që studentët duhet të përbushin për t’u diplomuar.

Riznic tha se mesazhe të tilla janë “të rrezikshme”.

“Ata po krijojnë terren pjellor që gratë të varen përsëri nga burrat”, tha ajo. “Kur janë të varura financiarisht, kjo hap hapësirë për shumë keqpërdorime në marrëdhënie dhe në nivel shtetëror, në kuptimin e të qenit aktiv në tregun e punës.”

“Ku mund të punojnë gratë nëse ndërpresin arsimimin e tyre për shkak të fëmijëve? Ky është mesazhi zyrtar, një model ideal i sjelljes. Ai prezantohet si diçka e mrekullueshme për gratë, por në thelb është e rrezikshme.”

“Gratë nuk janë inkubatorë të lëvizshëm që lindin fëmijë çdo nëntë muaj. Kjo është diçka që duhet të ndalet këtu dhe tani, sepse është një mjet për të riprodhuar një sistem të tërë shfrytëzues në të cilin fëmijët bëhen gjenerata të reja të punës së lirë, gratë po përjashtohen nga tregu i punës dhe i gjithë sistemi i keq-favorizuar po riprodhohet.”

Ky sistem tashmë ka dështuar tha Ivana (jo emri i saj i vërtetë), një tjetër e intervistuar në sondazhin e BIRN. Pas 17 vitesh në një marrëdhënie abuzive, Ivana la burrin e saj pasi ai e goditi 11 herë me thikë në vitin 2016. Ajo kishte vuajtur, ndër të tjera, edhe varësinë financiare, tha ajo për BIRN. “Kjo është arsyeja pse e durova për vite me radhë sepse nuk kisha ku të shkoja... nuk kisha asnjë mbështetje, prandaj e durova, derisa...”

Si rezultat i sulmit, dora e djathtë e Ivanës është lënduar rëndë dhe ajo ka mundësi të kufizuara për punë. Ajo tani jeton në një apartament me qira me vajzën e saj të rritur, por pretendoi se në lagje kishte tre “apartamente sociale” në pronësi të shtetit që rrinin bosh.

“Nuk e di si po jetoj tani”, tha Ivana për BIRN. “Kohët e fundit kam marrë 8000 dinarë (69 euro) ndihmë sociale. Me këtë ne duhet të paguajmë apartamentin, veshjet, ushqimin, taksat dhe gjithçka tjetër.”

Ajo nuk mori asgjë nga ish-partneri i saj pasi nuk kishte paraqitur kërkesë për ndarjen e pasurisë brenda një viti pas divorcit, duke thënë se askush nuk i kishte thënë për afatin.

Ivana tha se kishte pak besim të shërbimet sociale, jo pasi ish-partnerit të saj iu dha kujdestaria e djalit të tyre për kohëzgjatjen e procedurave të kujdestarisë për shkak të financave të saj. Procedurat filluan në vitin 2020.

“Nëse nuk ke si t’i mbash fëmijët, ata mund të t’i marrin.”

ndodh krahas dhunës fizike dhe psikologjike.”

Problemi qëndron në gjetjen e provave, tha Radovanovic për BIRN.

“Sistemi ynë i drejtësisë mund të mos ketë përvojë me këto lloj rastesh, kështu që nuk mund të them nëse kishim disa lloje provash që tregojnë se si të njohim formën ekonomike të dhunës”, tha ajo.

Në qytetin boshnjak të Tuzlës, Nedeljko Jurkic i qendrës lokale të shërbimeve sociale tha se, ndërsa dhuna ekonomike është e përhapur, kallëzimet formale janë “sporadike”.

“Në vit, ka ndoshta rreth dhjetë kallëzime, ndoshta edhe më pak”, tha ai për BIRN.

Arben Murtezic, drejtor i Qendrës për Edukimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Bosnje, një organ publik që punon në trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, tha se ligji duhet të shkonte më tej në përcaktimin e dhunës ekonomike.

“Me sa di unë, ne nuk kemi asnjë vendim në lidhje me abuzimin ekonomik”, tha Murtezic për BIRN. “Kjo lloj dhune shfaqet, bazuar në njohuritë e mia, së bashku me forma të tjera të dhunës... Edhe në ato vendime, kam parë, nuk përmendet konkretisht abuzimi ekonomik.”


“Është shumë e vështirë të izolosh abuzimin ekonomik. Nuk jam i sigurt se si do të dukej saktësisht një rast hipotetik i dhunës ekonomike, ku nuk ka lloje të tjera... Mendoj se është e rëndësishme të dimë më shumë për të. Pikërisht sepse nuk dimë, duhet të mësojmë.”

Riznic tha se ishte jetike që fenomeni të njihet më mirë në mënyrë që autoritetet më pas të mund të ndihmojnë një viktimë “t’ia dalë mbanë vetë”.

“Sigurisht që duhet të raportoni dhunën, por çfarë vjen më pas? Kjo është pyetja me të cilën gratë përballen kur largohen përfundimisht sepse nuk kanë ku të shkojnë”, tha ajo. “Shumë shpesh, ato nu mund të jetojnë normalisht dhe me dinjitet me pagën që kanë.”

Padejski sugjeroi përdorimin e një apartamenti me qira, të subvencionuar, që një viktimë do të mund ta përdorte pasi të largohet

How much do you spend on your needs on a monthly level?



Rezultatet e një sondazhi online të kryer nga BIRN. Infografika: BIRN/Igor Vujcic.

re, por sepse e shohin atë si rolin e tyre në shoqëri. “Ato e pranojnë rolin e tyre në shoqëri dhe marrëdhënie, duke pasur parasysh se rolet e tyre si gra dhe nëna kërkojnë një sakrificë të tillë”, tha Mujic për BIRN.

“Aspekti kulturor në të cilin jetojmë ka një ndikim të madh në qëndrimin e tyre në një marrëdhënie abuzive, sepse është nën kujdesin patriarkal ku ne mësojmë të vuajmë dhe të tolerojmë dhunën, të mos flasim për të.”

Pasojat mund të jenë dramatike, tha Buljic.

“Gratë humbasin besimin e tyre, ndihen të paafta për të punuar. Ato nuk i vlerësojnë gjërat që bëjnë në shtëpinë e tyre – rritja e fëmijëve, kujdesi për shtëpinë – të cilat janë të mëdha. Ato nuk e vlerësojnë këtë sepse dikush u thotë vazhdimisht se ato janë të paafta.”

Riznic u pajtua me këtë, duke thënë se dhuna ekonomike mund të dëmtojë shëndetin mendor të një gruaje.

“Ideja për të kërkuar leje për të blerë peçeta higjienike ose medikamente që u nevojiten – të gjitha këto janë forma të dhunës ekonomike”, tha Riznic. “Dhunë ekonomike është edhe kur një grua nuk ka mundësi ta kontrollojë financat e saj ose financat e përbashkëta ose kur nuk mund të marrë pjesë në ndarjen e financave. Kjo është poshtëruese dhe ndikon në shëndetin mendor të një personi.”

Padejski tha për BIRN: “Në planin afatgjatë, ajo fillon të besojë se nuk mund të fitojë para, se askush nuk do ta punësojë, se është e paafte për të punuar dhe se varet tërësisht nga partneri i dhunshëm. Ky është qëllimi i dhunuesit, të ketë pushtet të plotë mbi viktimën dhe të menaxhojë jetën e saj. Kjo çon në një ndjenjë pafuqie, mungesë perspektive dhe në zhvillimin e simptomave të caktuara të depresionit, ankthit dhe vetëbesimit të ulët.”

Dhuna ekonomike e përhapur, kallëzimet “sporadike”

Dhuna ekonomike njihet me ligj si në Bosnjë ashtu edhe në Serbi.

Megjithatë, në Novi Sad, qyteti i dytë i Serbisë, një zëdhënëse e Gjykatës Themelore tha se gjykata kishte regjistruar vetëm dy raste të drejtpërdrejta në lidhje me dhunën ekonomike që nga miratimi i Ligjit kundër dhunës në familje në Serbi në vitin 2016. Prokurorët e hoqën ratin e parë, ndërsa i dyti është në vazhdim. BIRN kontaktoi edhe Ministrinë e Drejtësisë, por nuk mori përgjigje.

“Kjo lloj dhune shumë rrallë shfaqet si një rast i pavarur i dhunës në familje, por është i pranishëm së bashku me forma të tjera të abuzimit”, tha zëdhënësjë e gjykatës së Novi Sadit, Svjetlana Radovanovic. “Më shpesh, ajo

REPORTAZH

‘Nëse ata nuk mbjellin, ne nuk bluajmë’: Sfidat e prodhimit të drithërave në Shqipëri

Biznesi i një fabrike mielli në Has – i njohur dikur si hambari i verilindjes së Shqipërisë - vihet në rrezik nga emigracioni i lartë, mungesa e subvencioneve dhe rritja e kostove të punës në bujqësi.



Gjatë punës në fabrikën e miellit në Krumë. Foto: Bashkim Shala.

BASHKIMSHALA | BIRN | HAS

Dy dekada më parë, katër vëllezërit Xhafa nga Hasi vendosën që t’i investonin paratë e fituara nga emigracioni në Britani në ngritjen e një fabrike mielli – një ndërtesë e vetmuar 4-katëshe në të djathtë të rrugës që lidh qytezën e Krumës me Gjakovën.

Asokohe, krahina e njohur dikur si hambari i verilindjes së Shqipërisë mbillte rreth 200 hektarë grurë në vit; gati 10 për qind e sipërfaqes së mbjellë para viteve ‘90, por sërish e mjaftueshme për planifikimin e biznesit.

Për vite me radhë, vëllezërit Xhafa ia dolën ta mbanin biznesin e tyre në këmbë. Ata blinin drithin e tepërt nga bujqit e zonës si dhe shisnin miell dhe shërbimin e blajës për fermerët e zonës së verilindjes.

Por parcelat e mbjella me grurë në Has janë duke u tkurrur vit pas viti dhe vëllezërit Xhafa po përgatiten për ditë më të vështira.

“Në Krumë kur unë kam hapur fabrikën, mbillleshin 200 hektarë me grurë. Vjet kanë qenë të mbjellë rreth 100 ha, ndërsa sivjet janë 70-80 ha,” thotë Petrit Xhafa, i cili e drejton fabrikën së bashku me të vëllanë, Abdylin.

Sipas Xhafës, prodhimi i drithit në zonë është ulur ndjeshëm për shkak të emigracionit të lartë, mungesës së ndihmës nga qeveria dhe shtrenjtimit të lëndës së parë në bujqësi.

“Subvencioni është zero. Kostoja e një hektari grurë shkon 90 mijë lekë deri në bluarje,” ankohet Xhafa.

“Emigracioni ka bërë punën e vet. Rreth 15 mijë hasjanë janë në Londër,” shtoi ai.

Tregu i drithit u kthye në qendër të vëmendjes pas fillimit të pushtimit rus në Ukrainë në shkurt të këtij viti. Të dy vendet në konflikt të armatosur janë ndër eksportuesit më të mëdhenj të drithërave në botë. Përjashtim nuk bën as Shqipëria, e ci-

la po përgatitet për mungesën e grurit në treg. Prodhimi vendas dhe fabrikat e përpunimit të grurit si ajo e vëllezërve Xhafa mund të ishin një shpëtim, por ky sektor i bujqësisë gjendet prej vitesh në krizë.

Pa mbështetje

Rrethi i Hasit mbart një traditë të hershme në mbjelljen e grurit, ndërsa afërsia me Gjakovën në Kosovë krijoi një përvojë të re në përpunimin e drithërave.

Pas viteve ‘90, familja Xhafa u nda përgjysmë; ndërsa dy prej vëllezërve emigruan në Britaninë e Madhe, dy të tjerët qëndruan në shtëpi dhe punuan në fabrikat e miellit në zonën e Gjakovës. Në vitin 2004, ata vendosën të ngrinin biznesin e tyre. Të trembur prej interesave të larta të bankave, ata përdorën për investimin të ardhurat e dy vëllezërve në emigracion.

Investimi nuk qe i pamenduar.

“Hasi është një njësi bujqësore për efekt të sipërfaqes së tokës, që është e madhe. Hasjanët e Shqipërisë para se ne të ngrinin fabrikën kanë bluar në Gjakovë,” i tha BIRN bashkëpronari i fabrikës, Abdyl Xhafa me profesion ekonomist.

“Ky investim është arritur edhe në sajë

të eksperiencës që morëm nëpër fabrikat në zonën e Gjakovës. Por sigurisht që iniciativa ka qenë e jona, por kemi pasë edhe ide nga disa njerëz të tjerë që ne kemi lidhje familjare,” shtoi Xhafa.

Prej vitit 2004, fabrika grumbullon tepërit e grurit të banorëve të Hasit, ndërkohë që kryen shërbime në bluarjen e grurit për mijëra banorë të verilindjes së Shqipërisë, duke filluar nga zona e Kalasë së Dodës në kufi me Dibrën e deri në Dragobitë e Valbonë të Tropojës.

Por vëllezërit numërojnë sot vështirësi të shumta. “Sot për sot po punojmë pa laps. Tregu është jashtë kontrollit. Ureja është rritur tre herë, ka shkuar 12 mijë lekë kuintali, nga 4800 lekë që ka qenë më parë,” thotë Petrit Xhafa.

Probleme të ngjashme has edhe fermeri Muhamet Peka nga Kruma, i cili e shet drithin në fabrikën e vëllezërve Xhafa.

Këtë vit, Peka ka mbjellë 7 hektarë grurë në tokat e veta dhe ato të marra me qira.

Fermeri ka kryer shkollën e mesme bujqësore dhe mekanike dhe ka punuar si autokombajnë para viteve ‘90. Pas rënies së regjimit, Peka e privatizoi autokombajnën, ndërsa djemtë në emigracion e ndihmuan



Fermeri Muhamet Peka duke parë parcelat e mbjella me grurë. Foto: Bashkim Shala.

që të blinte një traktor me të gjitha agregatet. “Po të mos kisha mjetet e mia, nuk do kisha leverdi të mbijlla grurë,” thotë Peka, ndërsa numëron çmimet e larta në punimin e tokës si dhe blerjen e farave dhe të plehrave. Fermeri ankohet për mungesën e mbështetjes nga qeveria dhe nuk e fsheh zilinë për bujqit nga Kosova fqinje, për të cilët thotë se subvencionohen nga qeveria e tyre.

Peka thekson se rendimenti i grurit në Krumë është i lartë dhe pak mbështetje do ta bënte kultivimin një punë me leverdi.

Tokë pa zot

Të gjendur përballë tokave të lëna djerë dhe rënies së vazhdueshme të prodhimit, vëllezërit Xhafa vendosën që të mbillnin vetë grurë. Ata morën me qira rreth 30 hektarë tokë këtë vit, por u përballën me një sërë peripecish dhe u detyruan që të bëjnë marrëveshje të dyfishta për tokën.

“Kam bërë marrëveshje edhe me privatë, por edhe me bashkinë Krumë për të njëjtën sipërfaqe toke,” thotë Petrit Xhafa.

Fabrika e tyre ka një kapacitet përpunimi rreth 1500 ton grurë në vit dhe në sezonin e grumbullimit, në këtë fabrikë mund të punësohen rreth 15-20 punëtorë në turn në një cikël pune me tre turne. Xhafa shtoi se është gati të mbjellë deri në 100 hektarë grurë nëse do të kishte ndihmë e do të subvencionohej, por mungesa e dokumentacionit e bën këtë të pamundur.

“Toka ekziston, por nuk ka zot. Nuk ke me kë të negociosh. 3-4 vite më parë punoja me cikël të mbyllur. Pas kësaj kohe i jam drejtuar edhe unë importit,” shtoi ai.

Problemet me pronësinë i pranon edhe Dashnor Seferi, drejtor i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qarkun e Kukësit. Seferi thotë se një pjesë e tokave të ish-ndërmarrjes bujqësore janë ende në proces privatizimi edhe pas 30 vjetësh nga rrëzimi i regjimit komunist.

“Përsa u përket tokave të ish-ndërmarr-

Rritja e çmimit të naftës po falimenton peshkatarët

Gati 40 për qind e peshkarexhave dhe motobarkave të peshkimit në vend nuk i ka ngritur spirancat që prej fillimit të marsit, ndërsa peshkatarët ankohen se rritja e çmimit të naftës po i çon drejt falimentimit.

ELVIS HILA | BIRN | LEZHË

Për 23 vjet me radhë, Adriatik Qaja dilte në det me anijen e tij të peshkimit dhe punësoi më vonë peshkatarë të tjerë. Por rritja e fundit e çmimit të naftës dhe mungesa e ndihmës e vulosi fatin e biznesit të tij.

“Duke qenë se çmimi i naftës u rrit e po ashtu dhe taksat ishin shumë të larta, unë falimentova. U detyrova të mbyll licensën e të shes peshkarexhën me të gjithë paisjet që kisha për peshkim,” tha Qaja për BIRN.

Pasi mbylli biznesin e tij, babai i pesë fëmijëve shkoi të punonte për anijen e peshkimit të një kolegu, por edhe aty e ndoqën të njëjtat vështirësi.

“Edhe pronari që unë po punoj aktualisht me të është drejt falimentimit. Sa të mbarojmë këtë furnizim naftë që kemi, do ta mbyllë dhe ai biznesin dhe do ta nxjerrë në shitje,” shtoi Qaja.

Peshkatarët ankohen se një pjesë e mirë e flotës nuk po del më në det për shkak të rritjes së çmimeve të naftës dhe shumë prej peshkatarëve po shkojnë drejt falimentimit.

Shqetësimi i tyre konfirmohet edhe nga të dhënat zyrtare nga Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, QNOD, e cila i tha BIRN në një përgjigje zyrtare se krahasuar me të njëjtën periudhë të 1 viti më parë, numri i anijeve të peshkimit që kanë dalë në det në të gjithë portet e vendit kishte rënë me 40 për qind, ndërsa në Shëngjin ishte përgjysmuar.

Sipas QNOD, një vit më parë nga porti i Shëngjinit kishin dalë për peshkim 141 peshkarexha, ndërsa në të njëjtën periudhë këtë vit vetëm 72 të tilla ishin vënë në lëvizje.

Në të gjithë vendin, numri i anijeve të peshkimit që dolën në det ra nga 2535 në 1539 brenda vitit.

Të dhënat përputhen me ndryshimet në çmimin e naftës, pavarësisht lehtësimit për këtë kategori nga akciza dhe taksa e qarkullimit. Pranverën e vitit 2021, peshkatarët e blinin një litër naftë me 70 lekë, ndërsa tani paguajnë më shumë se dyfishin me 150 lekë për litër.

Nga rritja në rënie të menjëhershme

Të dhënat e INSTAT të publikuara më herët tregojnë se sektori i peshkimit në Shqipëri kishte shënuar një rritje të qëndrueshme prej vitit 2016. Sasia e peshkut të kapur në Shqipëri u rrit nga 12.500 ton në vitin 2016 në 16,800 ton në vitin 2020.

Por me rritje e menjëhershme të çmimeve të naftës, peshkatarët i thanë BIRN se flota tashmë po qëndron e ankuroar.

“Këtu është një situatë shumë e vështirë. Që prej rritjes së çmimit të naf-

tës, puna është stopuar dhe rreth 90% e peshkarexhave nuk dalin në det,” thotë Tonin Zefi, përfaqësues i subjekteve të peshkimit në Shëngjin.

Ndërkohë, punonjësi i njërit prej bizneseve të peshkimit në Shëngjin, që kërkoi të mos identifikohet, thotë se subjekti për të cilin ai punon ka vendosur të ndalojë punën deri në stabilizimin e çmimit të karburantit, e për rrjedhojë ai nuk po paguhet.

“Prej 3 javësh kompania ku unë punoj e ka ndaluar punën. Shkak është bërë çmimi i lartë i karburantit. Pronari na ka thënë se e ka të pamundur ta përballojë dhe do të qëndrojmë pushim deri në stabilizimin e çmimit të karburantit,” tha ai.

Burri tha se kjo i kishte mohuar atij dhe familjes së tij të ardhurat e nevojshme për jetesë. “Me këtë punë mbaj familjen,” tha ai, ndërsa shtoi se shpresonte që kriza të mbyllej shpejt.

Iris Hasani, një peshkatar që punon me një barkë të vogël tha se situata ishte e ngjashme edhe për ta.

“Benzina është shumë shtrejtë. Ku mundemi me ja dal me benzinë? Çdo gjë është katastrofë. Çdo ditë e don nga 20 mijë lekë benzinë me dal në det, fitimi zero. Ka se vjen edhe bosh, pa peshk pa asisen,” tha ai.

Kriza prek edhe konsumatorin

Mosdalja e flotës së peshkimit në det është ndërjet edhe në bizneset e tjera të lidhura me peshkimin. Kuzhinieri Gjovalin Zeka, i cili ka një restorant në Ishull-Lezhë pranë lagunës së Vainit tha se tani ishte bërë mjaft e vështirë për të siguruar produktet e detit.

“Ne si biznes kemi hasur shumë vështirësi tek sigurimi i produktit. Në radhë të parë, peshkatarët nuk marrin

guximin fare të dalin në det. Një ndër arsytet është sepse ata nuk e kanë të sigurtë se çfare nxjerrin prej detit, por ama kanë të sigurtë shpenzimin që bëjnë,” thotë Zeka duke u solidarizuar me peshkatarët.

Shefi i kuzhinës thotë se situata është në përkeqësim. “Situata realisht është duke u vështirësuar çdo ditë e më shumë, rritja e çmimeve ka bërë këtë faktor,” shtoi ai.

Zeka thotë se për ata që kanë një restorant të bazuar te peshku i egër kjo ndikon drejtpërdrejt. “Vijnë shumë klienta edhe largohen, sepse unë nuk i siguroj peshk deti,” u ankua ai.

Kuzhinieri thotë se edhe rritja e çmimeve të produkteve të detit rrezikon të largojë klientët. “Imagjinoni që peshku ka çmim pak më të lartë, nuk po mundemi t’i prekim më me dorë fare”, thotë ai.

Të njëjtin shqetësim ka edhe Tonin Zefi, i cili thotë se nëse rritet çmimi peshku rrezikon të mos shitet. “Nuk mund ta rrisim më as çmimin e peshkut, sepse as qytetarët nuk kanë mundësi financiare ta blejnë,” tha ai. Për peshkatarët kjo do ishte një humbje më shumë, pasi rrezikon që produkti për të cilin janë lodhur të shkonte kot.

Një peshkatar i tha BIRN se mungonin mundësitë për ruajtje të peshkut të zënë.

Zefi thotë se për shkak të situatës, mjaft peshkatarë janë tashmë pa rroga. “Në peshkim janë të punësuar një numër i konsiderueshëm personash të cilët duke qenë se puna është bllokuar normalisht që nuk paguhet”, thotë Zefi. Për peshkatarët e vetmja mundësi për të normalizuar punën është ndërhyrja në çmimin e karburanteve.



Sipërmarrësi Petrit Xhafa ka vendosur të mbjellë vetë grurë pas rënies së prodhimit në zonë. Foto: Bashkim Shala.

jeve bujqësore, një pjesë janë në proces privatizimi. Në nëntor të vitit 2020 ka përfunduar afati i aplikimit për privatizim të tokave të ish NB-ve,” sqaroi Seferi.

Sipas tij, procesi është i komplikuar dhe një pjesë e mirë e tokës është e paqartë se kujt i përket. “Ky proces ende nuk ka përfunduar që me qenë të informuar se cilat toka kanë mbetur shtetërore që pastaj ministria e Bujqësisë t’i japë me qira. Këto do të jenë toka që nuk kanë aplikuar fermerët për privatizim,” shtoi Seferi.

Qemal Memishaj, përgjegjës i Sektorit të Ekstensionit Bujqësor në Kukës, është më optimist dhe mendon se skema e subvencionit ka filluar të funksionojë.

“Petrit Xhafa ka aplikuar për të përfituar skemën e naftës, pasi ka marrë tokë 28 hektarë tokë me qira nga Bashkia Has dhe do të jetë nga të parët që do përfitojë nga skema e naftës,” tha Memishaj.

Por Xhafa thotë se problemet e mbartura të bujqve të zonës dhe kriza e fundit e drithërave i ka vënë në dyshim ambiciet e tyre për zgjerimin e biznesit.

“Ne jetojmë me shqetësimet e fermerëve, pasi biznesi ynë lidhet edhe me ata. Nëse ata nuk mbjellin, ne nuk do të blujmë,” përfundoi Xhafa.



Anijet e peshkimit nuk dalin më në det në Shëngjin. Foto: Elvis Hila.

Intervistë

Xheni Karaj, një nga aktivistet e para LGBT në Shqipëri dhe fituese e një çmimi së fundmi nga Civil Rights Defenders, tregon për BIRN për luftën e vështirë me të cilën përballlet ende komuniteti i saj në betejën për barazi.

Xheni Karaj: “Ne nuk duhet të jemi qytetarë të dorës së dytë”

FJORI SINORUKA | BIRN | TIRANË

Kur Xheni Karaj filloi të angazhohej në aktivizmin LGBT 13 vjet më parë, ajo e dinte shumë pak se çfarë ishte aktivizmi – dhe organizatat përkatëse ishin ende në një fazë shumë bazë.

Në moshën 21-vjeçare, ajo mendonte se ishte ndoshta e vetmja lezbike në Shqipëri. Vitet e saj të adoleshencës u shënuan nga një depresion që reflektonte frikën e mos përbushjes së parashikimeve që shoqëria dhe familja kishin për të. Shumë gjëra kanë ndryshuar që nga viti 2009, por shumë mbeten të njëjta, thotë ajo.

Javën e kaluar, organizata ndërkom-betare për të drejtat e njeriut me bazë në Stokholm Civil Rights Defenders i dha asaj çmimin prestigjioz të mbrojtës së të drejtave civile për punën e saj për të sjellë ndryshim në komunitetin në vendin e saj, së bashku me Frank Mugisha nga Uganda.

Të dy janë cilësuar “dy nga aktivistët më të guximshëm LGBTI+ dhe mbrojtës të të drejtave të njeriut në botë”, duke punuar në mjedise ku “homofobia është e përhapur”.

Karaj thotë se nuk e priste çmimin. E zuri në befasi.

“Çmimi ishte në fakt i papritur sepse Civil Rights Defenders më kishin nominuar për tre ose katër vjet dhe kur më nominuan përsëri, nuk e mendoja kurrë se do të kisha ndonjë shans, sepse është një konkurs global”, tha ajo për BIRN në një intervistë.

“Ka aktivistë të të drejtave të njeriut nga e gjithë bota dhe ne e dimë se ka vende ku realiteti është shumë më i vështirë se Shqipëria” shton ajo.

Ajo thotë se çmimi do të shërbejë si një motivim i madh për të, megjithëse, “kur bëjmë aktivizëm, nuk mendojmë kurrë për këtë pjesë të vlerësimit nga jashtë.

“Të paktën për mua personalisht aktivizmi nuk ka qenë punë, por ka qenë një domosdoshmëri.”

“Bëja diçka që ishte më e madhe se unë”

Parlamenti i Shqipërisë e dekriminalizoi homoseksualitetin në vitin 1995, por komuniteti LGBT nuk ishte pjesë e diskursit social apo politik të Shqipërisë deri vonë. Gjuha e urrejtjes, diskriminimi dhe homofobia mbeten të pranishme.

Karaj, një nga aktivistet e para që luftoi për të drejtat LGBT, u bë një personazh publik në vend. Gjithçka filloi kur ajo takoi një çift lezbikesh amerikane dhe krijoi një grup në Facebook, “Aleanca kundër Diskriminimit”, të cilit oi bashkuan rreth 500 njerëz brenda tre muajve nga krijimi i tij.

Pasuan takime me anëtarë të komunitetit në bare dhe kafene. Pas kësaj, ata përdorën një qendër për të drejtat e grave për të mbajtur takime. Ajo krijoi organizatën



Aktivistja Xheni Karaj në zyrën e saj. Foto: BIRN.

Aleanca LGBT në vitin 2021.

Kjo atëherë “ishte e paimagjinueshme”, kujton ajo.

“Gjithmonë kam pasur frikë se dikush në punë do ta merrte vesh sepse nuk kisha dalë hapur në punë, as me familjen. Vetëm me një grup të ngushtë njerëzish.” “Mbah mend që kur printoja postera, më tmerronte mendimi: ‘Nëse shefi im vjen në zyrë dhe më shikon duke printuar këto postera, do të pyesë se pse po i printoj në zyrë? Kishte rreth 100 afishe bardh e zi’”, kujton Karaj.

“Këto ishin kushtet. Dhe natën kur dilnim për t’i ngjitur nëpër pemë në rrugë, prisnim deri në mesnatë, që të errësohej dhe të mos kishte shumë njerëz në rrugë. Nuk kishim pajisje. Dhe ngjitesin e blinin vetë”, vazhdon ajo.

Të nesërmen, kur u zgjua, pa se shumë prej posterave ishin grisur, por kishte edhe disa të tjerë që kishin shpëtuar.

